

KOMISIONI EVROPIAN

Bruksel, 27.06.2011
C(2011)4381 final

VENDIM ZBATUES I KOMISIONT

i datës 27.06.2011

për miratimin e Dokumentit Planifikues Indikativ Shumëvjeçar (MIPD) 2011-2013 për
Kosovën*

*Sipas RKSKB/UNSCR 1244/1999

VENDIM ZBATUES I KOMISIONT

i datës 27.06.2011

për miratimin e Dokumentit Planifikues Indikativ Shumëvjeçar (MIPD) 2011-2013 për Kosovën*

KOMISIONI EVROPIAN,

Duke pasur parasysh Traktatin për Funkcionimin e Bashkimit Evropian,

Duke pasur parasysh Rregulloren e Këshillit (EC) nr. 1085/2006 të 17 korrikut 2006 për themelimin e një Instrumenti për Asistencë të Para-Anëtarësimit (IPA)¹, si dhe në veçanti Nenin 14 (2) (a) të saj,

Derisa:

- (1) Rregullorja (EC) nr. 1085/2006 vendos një kornizë koherente për asistencë nga Bashkimi Evropian për vendet kandidatë dhe kandidatë potencialë. Neni 6 (1) i kësaj Rregulloreje kërkon që ndihma të jepet në bazë të dokumenteve të planifikimit indikativ shumëvjeçar, e përcaktuar për vendin përkatës në konsultim të ngushtë me autoritetet kombëtare. Më 10 korrik 2009, Komisioni miratoi DPISH (MIPD) 2009-2011 për Kosovën²
- (2) Në përputhje me Nenin 6 (3) të Rregullores (EC) nr 1085/2006, asistenca për vendet e listuara në Aneksin II të kësaj Rregulloreje, duhet të bazohet në Partneritetet Evropiane dhe të mbulojë prioritetet dhe strategjinë e përgjithshme që rezultojnë nga një analizë e rregullt e situatës në vend dhe në të cilën fazë të përgatitjes për integrimin e mëtejshëm në Bashkimin Evropian duhet të përqendrohet,
- (3) Këshilli ka krijuar për të gjitha vendet candidate dhe kandidatët potencialë një Partneriteti Anëtarësimi ose Partneritetit Evropian. Më 18 shkurt 2008, Këshilli miratoi Partneritetit Evropian të përditësuar me Serbinë, përfshirë Kosovën.³
- (4) Masat e parapara në këtë vendim janë në përputhje me mendimin e Komitetit për IPA.⁴

KA VENDOSUR ME SA VIJON:

Nen i veçantë

miratohet Dokumenti Planifikues Indikativ Shumëvjeçar (DPISH) 2011-2013 për Kosovën, i cili bashkangjitur në këtë dokument.

* sipas UNSCR 1244/1999

¹ OJ L 210, 31.7.2006, f. 82

² C (2009) 5438 of 10 July 2009.

³ Vendimi i Këshillit 2008/213/EC (OJ L80, 19.3.2008, f. 46)

⁴ Duke kujtuar Konkluzionet e Këshillit të 18 shkurt 2008, shtetet anëtare deklarojnë se miratimi i DPISH (MIPD)2011-2013 për Kosovën nuk paragjykon pozitën e secilit shtet anëtar për statusin e Kosovës, e cila do të vendoset në përputhje me praktikën e tyre kombëtare dhe të drejtën ndërkombëtare.

Bruksel, më 27.06.2011

*Për Komisionin,
Štefan FÜLE
Anëtar i Komisionit*

ANEKS

Instrumenti i Asistencës së Para-Anëtarësimit (IPA)

Dokumenti Planifikues Indikativ Shumëvjeçar

(DPISh/MIPD)

2011-2013

Kosovë*

* Sipas RKSKB/UNSCR 1244/1999

PËRMBAJTJA

1.	Objektivat strategjike të IPA-s.....	7
2.	Sfidat e përfituesit dhe vlerësimi i nevojave.....	7
2.1.	Strategjitë e Kosovës	9
2.2.	Marrëdhëniet me Bashkimin Evropian	10
2.3.	Mësimet e nxjerra	11
2.4.	Konsultimi me palët e interesit dhe donatorët	13
2.5.	Prioritetet e zgjedhura për asistencë nga BE-ja	14
3.	Sektorët kryesorë për mbështetje nga BE për periudhën 2011-2013	15
3.1.	Drejhtësia dhe Punët e Brendshme (fokusi në liberalizimin e vizave dhe gjyqësorin)	18
3.1.1.	Përshkrimi i sektorit.....	18
3.1.2.	Asistenca në të kaluarën dhe ajo aktuale (BE dhe donatorët tjerë)	19
3.1.3.	Objektivat sektoriale për mbështetje të BE-së gjatë tre viteve të ardhshme.....	20
3.2.	Zhvillimi i sektorit privat (fokusi në ambientin e tregtisë dhe biznesit).....	23
3.2.2.	Asistenca në të kaluarën dhe aktuale (BE dhe donatorët e tjerë).....	24
3.2.3.	Objektivat sektoriale për mbështetjen e BE-së gjatë tre viteve të ardhshme.....	25
3.3.	Reforma e Administratës Publike (fokusi në rishikimin funksional)	27
3.3.1.	Përshkrimi i sektorit.....	27
3.3.2.	Asistenca në të kaluarën dhe aktuale (BE dhe donatorët e tjerë).....	29
3.3.3.	Objektivat sektoriale për mbështetjen e BE-së gjatë tre viteve të ardhshme.....	29
4.	Lista e shkurtesave.....	33

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Qëllimi i këtij Dokumenti të Planifikimit Indikativ Shumëvjeçar (MIPD) është përcaktimi i prioriteteve të BE-së për ndihmë Kosovës për periudhën e programimit 2011-2013.

MIPD bazohet në nevojat e identifikuar në Raportin e Progresit, të miratuar më 9 nëntor 2010, strategjitë e Kosovës dhe Komunikatën e Komisionit të vitit 2009 *Kosova – Përmbushja e Perspektivës së saj Evropiane*. Gjatë hartimit të këtij MIPD janë konsultuar Qeveria e Kosovës, akterët vendorë, shtetet anëtare të BE-së dhe donatorë të tjerë.

Gjatë viteve të fundit Komisioni ka ndërmarrë një sërë hapash për të përmirësuar natyrën strategjike të këtij procesi dhe për të forcuar ndërlidhjen në mes të prioriteteve të përcaktuara në raportet e progresit dhe programimin e asistencës. Për ta ilustruar më mirë këtë fokus, dhe për të forcuar pronësinë nga ana e përfituesit, Komisioni do të shtojë shfrytëzimin e logjikës së bazuar në sektorë në planifikim e asistencës së para-anëtarësimit.

Për të rritur ndikimin e asistencës së IPA-s dhe për t'u fokusuar më shumë në rezultate të arritshme, Komisioni ka vendosur të përqendrojë përpjekjet e tij në sektorët e synuar. Një qasje sektoriale duhet të lehtësojë bashkëpunimin në mes të donatorëve dhe përfituesve, nën udhëheqjen e autoriteteve, aty ku është e mundur, duke eliminuar duplikimin e përpjekjeve dhe në mënyrë që të çojnë në efikasitet dhe efektivitet më të madh. Kjo, nga ana tjetër, duhet t'u mundësojë të gjithë grupeve të interesit që të përqendrohet gjithnjë e më shumë impakti i përpjekjeve tona të kombinuara.

Deri më tani, numri i programeve të plota sektoriale të zhvilluara nga vendet përfituese të IPA-së është i kufizuar. Megjithatë, duke filluar që gjithnjë e më shumë të përqendrohet në sektorë prioritarë, Komisioni do të mund të mbështesë më shume zhvillimin e programeve të tilla, në të cilat mund të bazohet asistencë e BE-së dhe e donatorëve të tjerë.

Nismat e marra para sysh nga Komisioni do të ndihmonin Kosovën të lëvizë para në fushën e vizave, tregtisë mbikëqyrjes ekonomike dhe fiskale, programeve të BE-së, Dialogut të Procesit të Stabilizim-Asociimit (PSA) dhe bashkëpunimit ndër-kufitar. Këto fusha përputhen me Agjendën Evropiane të Kosovës.

Për t'i përmbushur prioritetet e zgjedhura për mbështetje në periudhën e programimit 2011-2013, Komisioni do të fokusojë kryesisht ndihmën e tij në këta sektorë:

- Drejtësia dhe Punët e Brendshme (me fokus në liberalizimin e vizave dhe gjyqësor)
- Zhvillimi i sektorit privat (me fokus në tregti dhe mjedisin biznesor)
- Reforma e Administratës Publike (me fokus në rishikimin funksional)

1. OBJEKTIVAT STRATEGJIKE TË IPA-S

Objektivi i përgjithshëm i asistencës financiare të BE-së në Kosovë është të mbështesë përpjekjet e saj për reforma dhe drejt arritjes së pajtueshmërisë me standardet e BE dhe progresin në zbatimin e reformave të agjendës evropiane.

Agjenda Evropa 2020 u jep vendeve në procesin e zgjerimit një frymëzim të rëndësishëm për reforma. Kosova ftohet të marrë parasysh prioritetet e strategjisë dhe t'i përshtatet sfidave kryesore në kontekstin kombëtar. Politika e zgjerimit gjithashtu mbështet strategjinë Evropa 2020, duke zgjeruar tregun e brendshëm dhe rritjen e bashkëpunimit në fusha ku bashkëpunimi ndërkufitar është i rëndësishëm.

2. SFIDAT E PËRFITUESIT DHE VLERËSIMI I NEVOJAVE

Konkluzionet e Raportit të Progresit 2010 për Kosovën konfirmojnë se Kosova ka bërë progres për sa i përket kritereve politike. Kosova ka shtuar përkushtimin e saj ndaj agjendës evropiane dhe reformimit të politikave. Kosova gjithashtu ka bërë progres sa i përket reformës së sistemit gjyqësor, me miratimin e katër ligjeve të rëndësishme. Ndikimi i krizës ekonomike në ekonominë e Kosovës ka qenë i kufizuar. Kosova ka arritur progres të kufizuar drejt krijimit të një ekonomie funksionale të tregut. Progresi në përafrimin e legjislacionit dhe politikave të Kosovës me standardet evropiane vazhdon të jetë i përzier. Në fushën e tregut të brendshëm të BE-së ka pasur pak progres sa i përket zhvillimit të kornizës ligjore.

Megjithatë, raporti gjithashtu konfirmon që kapaciteti i administratës publike mbetet i dobët dhe gjyqësori nuk funksionon efektivisht. Sundimi i ligjit ka nevojë për fuqizim të mëtutjeshëm dhe mbetet shqetësim serioz. Rezultatet në luftën kundër korrupsionit janë të kufizuara. Fushat kryesore të interesimit vazhdojnë të jenë procedurat e prokurimit dhe sistemi gjyqësor dhe ai i zbatimit të ligjit. Kapaciteti i Kuvendit për shqyrtimin e projektligjeve dhe monitorimin e zbatimit pas miratimit mbetet i dobët. Mbikëqyrja parlamentare e Qeverisë duhet të fuqizohet më tej. Reforma e administratës publike mbetet një sfidë e madhe. Sa u përket kritereve ekonomike, nevojiten reforma dhe investime të konsiderueshme për t'i mundësuar Kosovës që të përballojë presionin e konkurrencës dhe fuqisë së tregut brenda BE-së. Sundimi i dobët i ligjit, pasiguria rreth të drejtave pronësore dhe normat e larta të interesit vazhdojnë të ndikojnë negativisht në mjedisin e biznesit dhe në zhvillimin ekonomik. Korniza ligjore në përgjithësi duhet të përforcohet. Papunësia mbetet shumë e lartë, posaçërisht në mesin e të rinjve.

Kosova numëron përafërsisht 2.2 milionë banorë dhe ka një sipërfaqe prej 10,887 km². Kosova ka shpallur pavarësinë më 17 shkurt 2008. Deri më tani Kosova është njohur nga 71 shtete, përfshirë 22 Shtete Anëtare të BE-së. Kosova gjithashtu ka miratuar kushtetutën e saj, e cila bazohet në Propozimin Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës. Përfaqësuesi Civil Ndërkombëtar mbikëqyr zbatimin e këtij propozimi.⁵

Në korrik 2010, Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë (GjND) nxori një mendim këshillëdhënës, i cili konkludoi se shpallja e pavarësisë së Kosovës nuk e ka shkelur të drejtën ndërkombëtare. Sekretari i Përgjithshëm i OKB-së ka nxjerrë pesë raporte për Kosovën – në shtator 2009, si dhe në janar, prill, qershor dhe tetor 2010. Sekretari i

⁵ Përfaqësuesi Civil Ndërkombëtar i raporton Grupit Ndërkombëtar Drejtues për Kosovën.

Përgjithshëm ka theksuar se ndryshimi i rrethanave në terren ka çuar në një përshtatje graduale të funksioneve dhe prioriteteve të misionit të OKB-së në Kosovë. Qëllimi strategjik i misionit është që të promovojë stabilitet, siguri dhe respektimin e të drejtave të njeriut.

KFOR-i, prania ushtarake e udhëhequr nga NATO, vazhdon të ofrojë siguri në tërë Kosovën. Gjatë periudhës raportuese, prania e tij në terren është zvogëluar gradualisht. Në këtë kontekst, Policia e Kosovës ka marrë përsipër përgjegjësinë për mbrojtjen e vendeve të caktuara fetare.

Situata në veri të Kosovës mbetet e tendosur, por stabile. Autoritetet e Kosovës kanë hapur një zyre për ofrimin e shërbimeve për qytetarët. Mungesa e dialogut në mes të Beogradit dhe Prishtinës ka pamundësuar progres në përmirësimin e jetës së komuniteteve lokale.

Kriza ndërkombëtare ekonomike dhe financiare ka pasur ndikim të kufizuar në ekonominë e Kosovës, e cila kryesisht ka ndikuar përmes zvogëlimit të fluksit të të hyrave nga remitencave dhe zvogëlimit të kërkesave të jashtme dhe çmimeve për eksportet kryesore të Kosovës. Sipas Entit Statistikor të Kosovës (ESK), rritja reale e Bruto Produktit Vendor (BPV) është ngadalësuar nga 6.9% sa ishte në vitin 2008 në 2.9% në 2009. Cilësia e statistikave ekonomike në dispozicion është përmirësuar disi gjatë vitit, por ende mbetet e dobët dhe nuk mundëson një vlerësim gjithëpërfshirës të gjendjes ekonomike në Kosovë⁶. Sipas vlerësimeve të FMN-së, BPV për kokë banori⁷ në vitin 2009 ka arritur në 1,766 EUR, që korrespondon me 7,5% të mesatares së Shteteve Anëtare të BE-së, krahasuar me 7,1% në vitin 2008.

Informatat lidhur me tregun e punës mbeten të pakta dhe vazhdojnë të jenë të dyshimta sa i përket saktësisë. Gjatë tremujorit të dytë dhe të tretë të vitit 2010, numri i të papunëve të regjistruar ka mbetur stabil në rreth 335,000, edhe pse rreth 1% më e ulët se një vit më parë. Vlerësohet se 30,000 të rinj, kryesisht me shkathtësi të pakta, hyjnë në tregun e punës pa pasur mundësi punësimi dhe shanse për zhvillim profesional. Përkundër disa zhvillimeve pozitive, si rritja e pjesëmarrjes dhe e shkallës së punësimit, tregu i punës në vitin 2009 mbetet problematik: shkalla e punësimit ishte vetëm 26.4%, shkalla e papunësisë qëndroi shumë lart, te 45%, dhe papunësia e të rinjve e posaçërisht papunësia afat-gjatë mbetet shumë e lartë, në 73%, respektivisht 81%, të të gjithë të papunësuarve.

Ka mungesë të veprimit adekuat në lidhje me përfshirjen sociale të grupeve specifike, përfshirë të romëve. Qasja e anëtarëve të grupeve të cënueshme në arsim, kujdes shëndetësor dhe mbrojtje sociale mbetet shqetësim serioz. Përfshirja efektive sociale e të gjitha grupeve dhe komuniteteve është vendimtare për përparim drejt pajtimit në mes të komuniteteve, e cila mbetet një sfidë e madhe në Kosovë.

Inflacioni mesatar ishte negativ (-2.4%) në vitin 2009. Normat mujore të inflacionit u bënë pozitive deri në fund të vitit 2009, dhe që nga atëherë janë përshpejtuar duke arritur 6.6% (vit pas viti) në dhjetor 2010.

⁶ Ende ka divergjenca në mes të të dhënave të ESK-së dhe serive të përdorura nga Ministria e Ekonomisë dhe Financave dhe FMN.

⁷ Masa për përdorimin e Barazisë së Fuqisë Blerëse nuk është në dispozicion për Kosovën.

Kosova përdor euron si monedhë zyrtare dhe Banka Qendrore e Kosovës (BQK) i ka të kufizuara instrumentet e politikave. Përpjekjet e Bankës ishin drejtuar kryesisht drejt përmirësimit të mbikëqyrjes së sektorit financiar. Deficiti buxhetor është rritur nga 0.2% të PBV-së në vitin 2008 në 0.8% të PBV-së në vitin 2009.

Në korrik, Kosova ka nënshkruar një marrëveshje *stand-by* me FMN-në.

2.1. Strategjitë e Kosovës

Korniza e fundit Afat-mesme e Shpenzimeve (KASh) e Kosovës është publikuar në qershor të vitit 2010 dhe mbulon periudhën 2012-2014. Buxheti i vitit 2010 është rishikuar në qershor. Kuvendi i Kosovës nuk arriti ta miratojë buxhetin e vitit 2011 para shpërbërjes së tij, në tetor 2010. Për më shumë, Kosova miraton një plan veprimi legjislativ dhe ka përditësuar Planin e Veprimit të Partneritetit Evropian (PVPE) në maj 2010. PVPE-ja përcakton veprimet e Kosovës si përgjigje ndaj sfidave të identifikuar nga Komisioni Evropian gjatë Dialogut të Procesit të Stabilizim-Asociimit dhe në Raportin e Progresit. Ekzistojnë disa strategji sektoriale; disa prej tyre janë miratuar nga Kuvendi. Megjithatë, Kosova duhet t'i ndërlidhë strategjitë e saja me procesin buxhetor. Kosova duhet të përmirësojë listën e prioritetëve të saja (d.m.th të filtrojë ato), gjithashtu duke pasur parasysh alokimin e asistencës nga IPA.

Një vlerësim i kohëve të fundit, i organizuar nga Komisioni Evropian, shqyrtoi mundësinë e prezantimit të një qasjeje të bazuar në sektorë (QBS) në Kosovë. Janë përdorur pesë kritere të vlerësimit për të vlerësuar mundësinë e futjes në përdorim të QBS-së, e këto janë: (1) ekzistenca e strategjive sektoriale që përshkruajnë objektivat e qeverisë dhe që mund të përdoren për të zhvilluar plane vjetore në bazë të prioritetëve të caktuara; (2) strategjitë sektoriale të mbulojnë të gjitha fushat e rëndësishme për procesin e anëtarësimit; (3) buxheti kombëtar duhet të reflektojë strategjitë sektoriale dhe të zhvillohet brenda një perspektive afatmesme, idealisht të lidhura për procesin e planifikimit të shpenzimeve kombëtare; (4) duhet të ketë një proces të formalizuar, të udhëhequr nga qeveria, që përfshin të gjitha palët e interesuara relevante, (5) ekzistimi i një sistemi të monitorimit me fokus në rezultate dhe që mund të përdoret për të vlerësuar progresin drejt arritjes së objektivave strategjike. Vlerësimi erdhi në përfundim se dy të parat nga pesë kriteret e realizueshmërisë janë përmbushur, dhe nxori këto rekomandime:

- Strategjitë sektoriale të Kosovës sektor duhet të mbulojnë të gjithë sektorët e lidhur me *acquis* dhe prioritetet e MIPD-së, pasi që për momentin ka boshllëqe të konsiderueshme në mbulim.
- Cilësia e strategjive ekzistuese ka nevojë të përmirësohet, kryesisht përmes zhvillimit të planeve realiste të veprimit dhe duke shtuar tregues të cilat mund të përdoren për monitorimin e performancës.
- Të gjitha strategjitë sektoriale prioritare duhet të jenë të ndërlidhura me KASh-in dhe të monitorohen financiarisht nga Ministria e Financave.
- Qeveria duhet të themelojë Njësinë e Planifikimit të Strategjive në kuadër të Zyrës së Kryeministrit.
- Ministria e Integritit Evropian duhet të marrë një rol udhëheqës në procesin e planifikimit strategjik sektorial. Aktualisht ajo merr përsipër vetëm rol koordinues.

- Një sistem funksional për monitorimin e zbatimit të strategjive kombëtare duhet të ekzistojë para se të fillohet me qasjen e bazuar në sektorë në Kosovë.
- Personeli i Ministrisë së Integrimit Evropian (MIE) dhe homologët e tyre në institucionet e linjës duhet të trajnohen mbi planifikimin strategjik sektorial.

Në mars 2010, Kryeministri i Kosovës emëroi Ministrin e Integrimit Evropian. Ministria e re përfshiu ish-Agjencinë për Koordinimin e Zhvillimit dhe Integrimit Evropian, e cila u krijua në vitin 2008 pas konferencës së donatorëve për Kosovën. Misioni i Ministrisë është që të sigurojë menaxhimin teknik, bashkërendimin dhe monitorimin e procesit të integrimit në Bashkimin Evropian, përmes përafrimit të legjislativimit me *acquis*, përgatitjes së politikave të integrimit evropian, koordinimit të asistencës financiare dhe informimit publik mbi procesin e integrimit në BE. Ministria duhet të ngre profilin politik të agjendës reformuese evropiane të Kosovës, dhe të rrisë efikasitetin dhe efektivitetin e zbatimit të saj. Janë vendosur prioritete të qarta politike për agjendën reformuese evropiane të Kosovës, pra liberalizimi i vizave dhe zgjerimi i fushës së sundimit të ligjit, reforma e administratës publike, marrëdhëniet tregtare dhe bashkëpunimi rajonal.

Qeveria e Kosovës ka miratuar disa strategji sektoriale, përfshirë ato për fushat: reforma e administratës publike, sundimi i ligjit, përfshirë atë të anti-korrupsionit, menaxhimin e integruar të kufijve, parandalimin e krimit, luftën kundër krimit të organizuar, drogave, trafikimit me qenie njerëzore dhe kundër terrorizmit. Kosova ka miratuar udhërrëfyesin e saj dhe planin përkatës të veprimit për liberalizimin e vizave. Ajo gjithashtu ka miratuar një strategji dhe plan veprimi të rishikuar për ri-integrimin e personave të riatdhesuar. Ajo ka miratuar strategjitë e të drejtave të njeriut dhe të drejtat e fëmijëve, atë për integrimin e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptas, të të drejtave të pronësisë intelektuale, të të mësuarit përmes Internetit (*e-learning*), punësimit dhe energjisë. Përveç kësaj, në shkurt 2011 Kosova ka miratuar një strategji të zhvillimit të pyjeve për periudhën 2010-2020. Plani Strategjik për Arsim i Kosovës (KESP) është nënshkruar nga Ministri i Arsimit.

Me qëllim të përmirësimit të planifikimit të politikave strategjike të Qeverisë, harmonizimit dhe vlerësimit, në shkurt të vitit 2010 Zyra e Kryeministrit ka themeluar Zyrën për Planifikim Strategjik. Kjo Zyrë punon ngushtë me Sekretariatit Koordinues të Qeverisë, Ministrinë e Integrimit Evropian, gjithashtu edhe me Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave. Për sa u përket sistemeve për monitorimin dhe zbatimin e strategjive të Kosovës, ekziston një sistem funksional i monitorimit dhe raportimit për Planin e Veprimit për Partneritet Evropian, që nga fillimi i vitit 2010. MIE dhe homologët e tyre në ministritë e linjës janë trajnuar mbi planifikimin strategjik, me fokus të veçantë në treguesit e vlerësimit dhe menaxhimin të ciklit të projektit.

2.2. Marrëdhëniet me Bashkimin Evropian

Shtetet Anëtare të BE-së vendosin për marrëdhëniet e tyre me Kosovën, në pajtim me praktikat kombëtare dhe të drejtën ndërkombëtare. 22 Shtete Anëtare të BE-së e kanë njohur pavarësinë e Kosovës. Mungesa e një qëndrimi harmonik për statusin e Kosovës nuk e ka penguar BE-në të ketë angazhim thelbësor në raport me Kosovën. Në Këshillin për Çështje të Përgjithshme, në dhjetor 2009, shtetet anëtare ftuan "Komisionin të marrë masat e nevojshme

për të përkrahur përparimin e Kosovës drejt BE-së në përputhje me perspektivën evropiane të rajonit.”⁸

BE-ja ka emëruar Përfaqësuesin Special të BE-së⁹ për të këshilluar dhe mbështetur procesin politik në Kosovë dhe për të siguruar qëndrueshmërinë e veprimit të BE së. BE ka vendosur gjithashtu misionin e saj me të madh deri më tani në kuadër të Politikës Evropiane të Mbrojtjes dhe Sigurisë.¹⁰ Misioni i Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë (EULEX) mbikëqyr, drejton dhe këshillon Kosovën në fushën e sundimit e ligjit, veçanërisht të policisë, drejtësisë dhe doganave, si dhe mban përgjegjësi të caktuara ekzekutive. Në korrik 2008, Komisioni organizoi një konferencë donatorësh për Kosovën, e cila rezultoi me zotime prej €1,200,000,000, ku përfshihen më shumë se €500,000,000 nga buxheti i BE-së. BE dhe Shtetet Anëtare të saj së bashku, zotuan pothuajse €800,000,000. Komisioni tashmë ka lëvruar fondet që ka zotuar dhe ka bërë përparim të mirë në kontraktimin e fondeve të IPA-së. Kosova vazhdon të përfitojë nga asistenca financiare e BE-së në kuadër të Instrumentit të Asistencës së Para-anëtarësimit, CARDS¹¹, Instrumentit për Stabilitet dhe iniciativave të tjera. Kosova ka marrë këstin e parë të asistencës makro-financiare (30 milionë euro) në shtator. Kësti i dytë prej 20 milion nuk ishte lëvruar, pasi që kushti kryesor për lëshimin e tij nuk ishte përmbushur para skadimit të ndihmës në dhjetor 2010.

Në tetor 2009, Komisioni miratoi një komunikatë Parlamentit Evropian dhe Këshillit të titulluar “Kosova – përmbushja e perspektivës së saj evropiane”¹². Qëllimi i komunikatës ishte të shfrytëzoheshin zhvillimet e deritanishme për të identifikuar sfidat në rrugën e Kosovës për në Evropë, të konfirmoheshin masat që duhet ndërmarrë Kosova për t’i adresuar këto sfida, dhe që të propozoheshin instrumentet e BE-së për të ndihmuar Kosovën më tej në zhvillimin e saj politik dhe socio-ekonomik.

Në këtë komunikatë, Komisioni ka identifikuar prioritetet kyçe për Kosovën, me fokus në agjendën e reformave drejtë BE-së. Komunikata konfirmoi që burimet e IPA-së do të shënjestrojnë mbështetjen e sundimit të ligjit, reformën e administratës publike dhe përpjekjet për përmirësimin e ambientit biznesor në Kosovë. U konfirmua gjithashtu se do të kihet parasysh mbështetja për infrastrukturë. Është specifikuar se Komisioni do të mbështesë, përmes asistencës financiare dhe teknike, nismat e përfshira në rekomandimet e kësaj komunikate. Nismat e marra parasysh nga Komisioni do të ndihmonin Kosovën të lëvizte para në fushën e vizave, tregtisë, mbikëqyrjes ekonomike dhe fiskale, programeve të BE-së, Dialogut të Procesit të Stabilizim-Asociimit (PSA) dhe bashkëpunimit ndër-kufitar. Këto fusha përputhen me Agjendën Evropiane të Kosovës.

2.3. Mësimet e nxjerra

⁸ Konkluzionet e GAC ref. 17169/09 të datës 8 dhjetor 2009

⁹ Veprimi i përbashkët i Këshillit 2008/123/CFSP i datës 4 shkurt 2008, i përditësuar më vonë. Përditësimi i fundit skadon më 30 prill 2011.

¹⁰ Veprimi i përbashkët i Këshillit 2008/124/CFSP i datës 4 shkurt 2008, i përditësuar më vonë. Përditësimi i fundit skadon në qershor 2012.

¹¹ Asistenca e Komunitetit për Rindërtim, Zhvillim dhe Stabilizim (origj. Community Assistance for Reconstruction, Development and Stabilisation)

¹² COM (2009) 5343 e 14 tetorit 2009.

Mësimet e nxjerra nga përvoja me CARDS dhe IPA sugjerojnë se bashkërendimi i donatorëve kërkon mbështetje. Duhet të ketë lidhje të qarta për zhvillimit të Kosovës dhe planeve të veprimit, si buxheti dhe Korniza Afatmesme e Shpenzimeve (KASh). Zhvillimi i strategjive sektoriale në sektorët kyçë duhet të ndihmojë në identifikimin e nevojave dhe të sigurojë rëndësinë e projekteve. Planifikimi i duhur dhe renditja e asistencës së IPA-së vazhdon të jetë e rëndësishme për të siguruar qëndrueshmëri dhe pronësi.

Një raport i sintetizuar i projekteve të financuara nga BE në Kosovë, monitoruar gjatë periudhës 2009 – 2010, i nxjerrë nga vëzhgues të jashtëm në nëntor 2010, ofron një analizë të përmbledhur të projekteve individuale të IPA-së në vitin 2009 dhe 2010. Ky raport ofron një vlerësim të dobishëm të ecurisë së projekteve të IPA-së në Kosovë dhe zhvillimin e tyre deri më sot. Raporti arrin në përfundimin se në vitin 2010 me rezultatin e përgjithshëm mesatar të projekteve të IPA është përmirësuar me 6% dhe se pjesa e 'shumë mirë' dhe 'mirë' e kryerjes së projekteve është rritur me 9,5% në krahasim me vitet e mëparshme. Raporti thekson se veçanërisht *efektiviteti* i projekteve të IPA-së është përmirësuar. Raporti sugjeron se kjo është për shkak të rezultateve më të mira të projekteve dhe përdorimit të tyre nga përfituesit. Kjo konfirmon që qasja Komisionit duke vazhduar të vë theks të veçantë në ndikimin dhe rezultate të prekshme, është duke funksionuar. Raporti konfirmon gjithashtu se edhe pse projekte janë vlerësuar mirë edhe në kategoritë *relevancë dhe cilësi të projektimit*, këto dy kritere kërkojnë më shumë vëmendje. Kjo tregon se më shumë përpjekje janë të nevojshme, si gjatë programimit ashtu edhe gjatë hartimit të Termave të Referencës. Për këtë qëllim, Komisioni është duke shqyrtuar vendosjen e një mekanizmi të vlerësimit homolog, në fillim të vitit 2011.

Monitorimi i jashtëm ka vlerësuar impaktin në përgjithësi, apo perspektivën e impaktit të projekteve, ku ndikimi deri më sot ende nuk mund të matet, si 'i mirë'. Kosova duhet të punojë mbi këtë bazë. IPA duhet të përqendrohet në një numër të kufizuar të prioriteteve kyçe, të cilat duhet të harmonizohen ngushtë me agjendën evropiane të Kosovës për reforma dhe të lidhura gjithnjë me strategji sektoriale të përlllogaritura/buxhetuara.

Përzgjedhja e projekteve duhet të pasqyrojë planifikim të përmirësuar, prioritetizim dhe rrjedhshmëri, dhe bashkërendim më të mirë me donatorët e tjerë. Mundësia që të lidhen donatorët e tjerë me menaxhimin e IPA-së në fushat ku këto kanë një avantazh krahasues do të shqyrtohet më tej. Pas konferencës së donatorëve në Bruksel, në korrik 2008, pronësia e Kosovës në projektet e IPA-së duhet të vazhdojë të fuqizohet, dhe koordinimi i donatorëve duhet të marrë parasysh një ulje graduale e pranisë së ndihmës dypalëshe dhe rritje e përqendrimit në efektivitetin e fondeve IPA.

Ndërsa Kosova i afrohet Evropës gjithnjë e më shumë dhe përafrimi me standardet evropiane bëhet gjithnjë e më i rëndësishëm, duhet të merren parasysh implikimet administrative dhe financiare të përafrimit me *Acquis* për administratën e Kosovës. Kapaciteti absorbues i administratës duhet të merret parasysh me rastin e dizajnit të programeve për të përfituar maksimalisht nga ndihma e dhënë, përfshirë kapacitetin e saj për zhvillimin e mekanizmave të brendshëm për vlerësim të kapaciteteve institucionale. Monitorimi i duhur i programeve dhe projekteve, si nga përfituesit ashtu edhe nga Komisioni, është një kërkesë kryesore për të garantuar rezultatet e dëshiruara apo për t'ia përshtatur aktivitetet rrethanave me ecuri të shpejtë.

2.4. Konsultimi me palët e interesit dhe donatorët

Komisioni Evropian, përfituesit e IPA-s, shtetet anëtare të BE-së dhe donatorë të tjerë janë pajtuar se ka nevojë për një ndryshim në qasjen ndaj planifikimit dhe programimit të asistencës IPA, pra duhet lëvizur nga qasja e bazuar në projekte drejt një qasjeje me bazë sektoriale ose programore. Në prill 2010, Komisioni ka informuar autoritetet e Kosovës, si dhe Shtetet Anëtare të BE dhe donatorë të tjerë të pranishëm në Kosovë, në lidhje me rishikimin e qasjes së tij planifikuese dhe ka ftuar palët e interesuara për kontributin e tyre. Në qershor 2010, palët e interesuara janë ftuar për të komentuar një draft të parë të këtij MIPD. Palët e interesuara janë konsultuar përsëri në nëntor 2010. Në përgjithësi, komentet e palëve të tjera të interesuara kanë treguar një dakordim të gjerë mbi prioritetet e ardhshme të IPA-së në Kosovë. Të gjitha komentet, përfshirë kryesisht ato nga vetë administrata e Kosovës, por edhe Shtetet Anëtare të BE-së dhe shoqëria civile, janë marrë plotësisht në konsideratë në hartimin e këtij MIPD.

Me qëllim të ristrukturimit të përpjekjeve të Kosovës dhe donatorëve, dhe kështu për të përmirësuar efektivitetin dhe impaktin e programeve në Kosovë, Qeveria ka vendosur të fillojë një qasje të bazuar në sektorë në planifikimin dhe zbatimin e asistencës. Ministria e Integritimit Evropian dhe donatorët janë pajtuar për të ngritur një mekanizëm, i cili strukturon ndërveprimin në kuadër të Qeverisë së Kosovës, si dhe në raport me donatorët. Ky mekanizëm ka këto objektiva:

- krijimin e një forumi, ku administrata e Kosovës së bashku me komunitetin e donatorëve të mund të diskutojnë fushat prioritare për mbështetje në përputhje me PVPE, KASH dhe dokumentet e tjera kyçe strategjike të Qeverisë;
- përmirësimin e aktiviteteve mbështetëse për Kosovën në mesin e komunitetit të donatorëve për të shmangur mbivendosjen dhe/ose duplikimin e aktiviteteve;
- mundësimin e shfrytëzimit optimal të burimeve të pakta (njerëzore dhe financiare) që janë në dispozicion në Kosovë dhe për Kosovën.

Kosova ka ngritur një Platformë për Administrimin e Ndihmës së Jashtme, me mbështetjen e komunitetit të donatorëve, veçanërisht Komisionit Evropian dhe SHBA-së. Kjo iniciativë do të përmirësojë menaxhimin dhe koordinimin e ndihmave, për të lehtësuar ndërlidhjen në mes të ndihmës së donatorëve dhe Planit të Veprimit për Partneritet Evropian (PVPE), përmirësuar harmonizimin e PVPE-së me Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve (KASH), reduktuar kostot e transaksioneve në mbledhjen dhe raportimin për ndihmën e donatorëve, përmirësuar shtrirjen e asistencës së donatorëve për strategjitë sektoriale të Qeverisë, dhe për të ofruar informata të përditësuara dhe në dispozicion të publikut për aktivitetet e ndihmës së planifikuar dhe në vazhdim.

Komunikata e Komisionit Evropian mbi Strategjinë e Zgjerimit dhe Sfidat Kryesore 2007-2008 dhe dokumentet relevante strategjike (2008, 2009 dhe 2010) kanë theksuar rëndësinë e mundësisë që shoqëria civile të luajë rolin e saj në një demokraci pjesëmarrëse. “Instrumenti i Shoqërisë Civile“ (*Civil Society Facility - CSF*), financuar si nga IPA me Shumë Përfitues ashtu edhe programet vjetore të IPA-së, është krijuar si mjet për të mbështetur financiarisht zhvillimin e shoqërisë civile. CSF përfshin veprime për të forcuar lirinë e shprehjes, pasi që kjo paraqet një parakusht themelor për një demokraci funksionale. Duhet vendosur kornizë të

përshtatshme ligjor që t'u mundësojë mediave të veprojnë lirisht. Një rrjet i tryezave të asistencës teknike (TACSO) është themeluar në Ballkanin Perëndimor. Ky rrjet është funksionalizuar në vjeshtë të vitit 2009. Gjithashtu janë themeluar Grupet Këshillëdhënëse Vendore, të përbërë nga përfaqësuesit e delegacioneve të BE-së, qeverive, shoqërisë civile dhe donatorë të tjerë.

2.5. Prioritetet e zgjedhura për asistencë nga BE-ja

Konkluzionet e Raportit të Progresit 2010 për Kosovën konfirmojnë se Kosova ballafaqohet me sfida të mëdha. Kosova duhet të bëjë progres të mëtjshëm në vendosjen dhe konsolidimin e sundimit të ligjit dhe duhet të përmirësojë funksionimin dhe pavarësinë e gjyqësorit. Duhet të demonstrohen rezultate konkrete në luftën kundër korrupsionit, pastrimit të parave dhe krimit të organizuar. Kosova gjithashtu duhet të forcojë kapacitetet, pavarësinë dhe profesionalizmin e administratës publike dhe të përmirësojë mjedisin e saj biznesor. Kosova ka nevojë të krijojë një politikë të qëndrueshme makro-ekonomike dhe fiskale. Reforma dhe investime të konsiderueshme duhet të ndiqen për të mundësuar ne plan afatgjatë përballimin e presionit konkurrues dhe forcat e tregut brenda BE-së. Progresi në përafrimin e legjislacionit dhe politikave të Kosovës me standardet evropiane është e përzier. Korniza ligjore është zhvilluar më tej në disa fusha, por në fusha të tjera është akoma në një fazë të hershme. Zbatimi i standardeve evropiane mbetet i kufizuar.

Komunikata e Komisionit “Kosova - përmbushja e perspektivës evropiane”¹³, nxjerr në pah prioritetet për Kosovën për të siguruar progres në agjendën e saj evropiane të reformave dhe identifikon masat që BE-ja mund të ndërmarrë për të ndihmuar në këtë. Komisioni ka propozuar një numër masash për të avancuar marrëdhëniet BE – Kosovë. Është propozuar të ecet përpara me një qasje të strukturuar drejt liberalizimit eventual të vizave, për të zgjeruar Masat Autonome Tregtare dhe për të propozuar direktivat negociuese për një marrëveshje tregtare pasi që Kosova t'i përmbushë kërkesat përkatëse, për të shqyrtuar mundësinë që Kosova të marrë pjesë në programet e BE-së për *Kulturë* dhe *Evropa për Qytetarët*, dhe që të lidhen me iniciativat e BE-së në fusha si punësimi, arsimit ndërmarrësia, dhe rinia. Gjithashtu është propozuar të avancohet dialogu politik me Kosovën dhe të zgjerohet fushëveprimi i asistencës financiare për Kosovën, të përfshihet nën komponentin e dytë të IPA-së – bashkëpunimi ndër-kufitar. Këshilli ka marrë parasysh propozimet për të mundësuar shfrytëzimin e instrumenteve të Komunitetit për të ndihmuar zhvillimin politik dhe socio-ekonomik të Kosovës, në harmoni me konkluzionet Këshillit Europian të dhjetorit 2007 dhe qershorit 2008. Këshilli ka theksuar rëndësinë e masave lidhur me vizat dhe tregtinë, pa paragjykuar qëndrimet e Shteteve Anëtare për statusin. Inkurajohet Komisioni për të hapur mundësitë për Kosovën të marrë pjesë në programet e BE, integrimin e Kosovës në kornizën e mbikëqyrjes ekonomike dhe fiskale, aktivizimin e komponentit të dytë të IPA-së, dhe fuqizimin e Dialogut të Procesit të Stabilizim-Asociimit, në vazhden e konkluzioneve të Këshillit për Çështje të Përgjithshme, të datës 8 dhjetor 2009. Pas këtyre konkluzioneve të Këshillit, të 8 dhjetorit 2009¹⁴, Komisioni ka avancuar këto masa. Megjithatë, përparimi i dukshëm do të vazhdojë të varet nga përpjekjet e bëra nga vetë Kosova në zbatimin e agjendës evropiane të reformave.

¹³ COM (2009) 5343 e datës 14 tetor 2009.

¹⁴ Konkluzionet e GAC ref. 17169/09 të datës 8 dhjetor 2009

Nga ky MIPD janë identifikuar këto prioritete për mbështetje nga IPA:

Prioriteti i parë është përkrahja e përpjekjeve të Kosovës drejt përparimit të mëtejshëm në vendosjen dhe konsolidimin e sundimit të ligjit dhe përmirësimin e funksionimit të gjyqësorit dhe pavarësisë së tij, përfshirë luftën kundër korrupsionit, si dhe luftën kundër krimit të organizuar, trafikimit të qenieve njerëzore dhe drogës, kontrabandës dhe pastrimit të parave. Mbështetja do të përfshijë, ndër të tjera, trajnime për zbatimin e ligjit dhe për gjyqësorin, do të ngre kapacitetet për ndërmarrjen e hetimeve proaktive (edhe financiare) dhe mbrojtjen e dëshmitarëve. Përpjekjet duhet të synojnë në mbështetjen e progresit të Kosovës në zbatimin e strategjisë së liberalizimit të vizave. Nuk ka asnjë strategji apo qasje gjithëpërfshirëse për sektorin e sundimit të ligjit. Megjithatë, ka një numër strategjish dhe planesh të përziera të veprimit. Një numër i reformave kryesore janë të nevojshme, të cilat BE-ja duhet ti mbështesë. Kjo mbështetje mund të çojë në zhvillimin e ardhshëm të një qasjeje të gjerë sektoriale në fushën e sundimit të ligjit.

Prioriteti i dytë është përkrahja e përpjekjeve të Kosovës për të përmirësuar mjedisin e saj të biznesit, për të tërhequr investime, stimulimin e zhvillimit dhe krijimin e vendeve formale të punës për të siguruar që zhvillimi socio-ekonomik i Kosovës të mund të vazhdojë. Përpjekjet janë kryesisht të drejtuara nga kërkesat e një marrëveshjeje të mundshme tregtare me BE-në, dhe do të synojnë ngritjen e kapaciteteve administrative dhe teknike të Kosovës në këtë drejtim. Këto përpjekje do të zhvillohen brenda kornizave më të gjera të aktiviteteve për mbështetjen e zhvillimit socio-ekonomik të Kosovës, dhe do të përshtaten me një sërë strategjish sektoriale të përbëra, sidomos me industrinë e Kosovës, NVM-të dhe strategjitë e punësimit. Ky prioritet i dytë do të harmonizohet me strategjinë evropiane për rritje të zgjuar, të qëndrueshme dhe përfshirëse (*Europe 2020*).

Prioriteti i tretë është përkrahja e Kosovës në sigurimin e ofrimit të shërbimeve publike për të gjithë personat dhe krijimin e një administrate publike profesionale, të përgjegjshme, të qasshme, përfaqësuese, e pa ndërhyrje politike, në veçanti duke mbështetur Strategjinë e përditësuar të Kosovës për Reformën e Administratës Publike dhe Planin përkatës të Veprimit, zhvillimin e të cilëve e ka ndihmuar BE.

3. SEKTORËT KRYESORË PËR MBËSHTETJE NGA BE PËR PERIUDHËN 2011-2013

Asistenca e IPA-së synon mbështetjen e pjesëmarrjen e Kosovës në Procesin e Stabilizim-Asociimit në Bashkimin Evropian për Ballkanin Perëndimor. Në veçanti IPA-ja duhet të ndihmojë Kosovën ta përmbushë perspektivën evropiane që e ndan me pjesën tjetër të Ballkanit Perëndimor. Në vazhdim të komunikatës për Kosovën të vitit 2009 dhe Konkluzioneve përkatëse të Këshillit, mbështetja e IPA-së për periudhën e mbuluar nga ky MIPD do të shënjestrojë: sundimin e ligjit, ekonominë, tregtinë dhe industrinë, si dhe reformën e administratës publike. Si Dialogu i PSA-së ashtu edhe Partneriteti Evropian do të vazhdojnë të shërbejnë si kornizë e asistencës së IPA-së në Kosovë.

Në fushën e drejtësisë dhe punëve të brendshme, MIPD do të fokusohet kryesisht, por jo ekskluzivisht, në përmbushjen e kërkesave për liberalizimin e vizave, për t'u konfirmuar në strategjinë e Kosovës për liberalizimin e vizave. Përveç kësaj, MIPD do të fokusohet në forcimin e pavarësisë dhe përgjegjshmërisë së gjyqësorit, do të mbështesë përpjekjet e Kosovës për të reduktuar kohëzgjatjen e procedurave gjyqësore dhe uljen e numrit të rasteve

të grumbulluara, të mbështesë përpjekjet e Kosovës për të luftuar krimin e organizuar, korrupsionin, pastrimin e parave dhe trafikimin me qenie njerëzore dhe drogë, të ndihmojë në përgatitjen e legjislacionit përkatës për të mbrojtur grupet e cënueshme në sistemin e burgjeve dhe mbështetjen e zbatimit të tij; të mbështesë përmirësimin e menaxhimit të të dhënave dhe shkëmbimin brenda dhe ndërmjet agjencive të zbatimit të ligjit, dhe të zhvillojnë trajnime të qëndrueshme.

Në fushën e zhvillimit të sektorit privat, MIPD do të përqendrohet kryesisht, por jo ekskluzivisht, në zbatimin e rekomandimeve lidhur me një marrëveshje të mundshme tregtare, pas misionit faktmbledhës për tregti, të korrikut 2010. Përveç kësaj, MIPD do të synojë të përmirësojë kornizën institucionale dhe ligjore për NVM-të lidhur me politikatat publike dhe zhvillimin e shërbimeve publike për bizneset dhe të përmirësojë prokurimin publik dhe politikatat e konkurrencës. Më tej, MIPD do të ndihmojë në adresimin e çdo sfide tjetër të identifikuar nga misioni i sipërpërmendur faktmbledhës ose çështje tjetër të rëndësishme të menjëhershme për një marrëveshje të mundshme tregtare.

Në fushën e zhvillimit të administratës publike, MIPD do të përqendrohet kryesisht, por jo ekskluzivisht, në zbatimin e rishikimit funksional të administratës publike në Kosovë. Për më tepër, MIPD do të synojë të rrisë pavarësinë e administratës publike, të përmirësojë efikasitetin dhe efektivitetin e administratës publike në nivel qendror dhe lokal, të aftë për të përmbushur sfidat e integritetit në BE, përmirësimin e administrimit të sistemeve financiare për të kontrolluar më mirë financat publike; forcimin e kontrollit dhe organeve të mbikëqyrjes brenda administratës publike dhe përmirësimin e prodhimit të statistikave në të gjitha fushat në përputhje me kërkesat e BE-së.

Nga IPA mund të financohen veprime që bien jashtë fushëveprimit të sektorëve kryesorë, të tilla si, por jo vetëm, në: i) identifikimin dhe përgatitjen e projekteve/programeve sektoriale; ii) veprime që lidhen me *acquis* që duhet të miratohen/zbatohen sipas një orari ekzistues (p.sh. korniza negociuese apo Plani Kombëtar për Adoptimin e *Acquis*); iii) pjesëmarrjen në Programet BE-së në të cilat pranohet Kosova, përveç rasteve kur ato janë të përfshira në një nga sektorët e zgjedhur më sipër; iv) masat mbështetëse për zbatimin, monitorimin dhe auditimin e programeve të IPA-së, (v) mbështetjen për dialogun mbi çështjet praktike ndërmjet Kosovës dhe Serbisë; (vi), si dhe investimet.

Në përputhje me Strategjinë Evropa 2020, Kosova gjithashtu duhet të sigurojë që sfidat lidhur me ndryshimin klimatike të adresohen, në veçanti duke ulur intensitetin e liritit të gazrave ndotës gjatë zhvillimit të saj ekonomik. Qëllimi për të ulur emetimet e gazrave ndotës do të merren parasysh në të gjithë sektorët relevantë të MIPD-së, në veçanti në sektorët e transportit, energjisë, mjedisit dhe bujqësisë. Projektet për të mbështetur mbylljen e hershme të termocentralit 'Kosova A' do të ndihmonte në realizimin e këtyre qëllimeve. Për më tepër, e gjithë ndihma financiare duhet të jetë në përputhje me parimin e zhvillimit të qëndrueshëm dhe për të përmbushur kërkesat e *acquis*-së përkatëse nga fusha e mjedisit dhe klimës, në veçanti VNM-në si dhe direktivën e Zogjve dhe atë të Habitaveve.

Për të ndihmuar futjen e një qasje sektoriale në Kosovë, ndihma financiare do të konsiderohet për projektimin e modaliteteve të reja të përbashkëta, objektiv kryesor i të cilit do të duhej të ishte të forcohej stimulimi dhe përdorimi i këtyre sistemeve nga donatorët e Qeverisë. Kjo punë do të kryhet në bashkëpunim të ngushtë me donatorë të tjerë të pranishëm në Kosovë.

Në përputhje me rekomandimet e strategjisë së 2010 ELARG, lufta kundër korrupsionit është një sfidë thelbësore për shumicën e vendeve në procesin e zgjerimit. Rezultate të prekshme dhe të besueshme në luftën kundër korrupsionit janë elemente të rëndësishme për të lëvizur përpara në fazat e procesit të anëtarësimit në BE. Ndhima financiare do t'i kushtojë vëmendje të veçantë këtij aspekti, pasi që korrupsioni mbetet i përhapur në shumë fusha dhe ka nevojë të trajtohet. Sa i përket gjinisë, mundësive të barabarta dhe jo-diskriminimit, do të respektohen në fazën e programimit dhe atë të zbatimit, në veçanti në lidhje me programet e mbështetjes socio-ekonomike. Personat që u përkasin komuniteteve pakicë dhe grupeve të cenueshme do të pasqyrohen në të gjitha aktivitetet e programuara sipas IPA-së, në veçanti kur ajo ka lidhje me shërbimet publike, çështjet legjislative dhe zhvillimin socio-ekonomik.

Korniza aktuale Financiare Indikative Shumëvjeçare 2011-2013¹⁵ i ndan Kosovës edhe një shumë prej €12.4 milionësh. Nën menaxhimin e drejtpërdrejtë të Zyrës Ndërlidhëse të Komisionit Evropian në Prishtinë, Kosova është duke shënuar progres të mirë në zbatimin e IPA-së.

Mbështetja e IPA –së për periudhën e mbuluar nga ky MIPD do të ketë në shënjestër sundimin e ligjit, ekonominë, tregtinë dhe industrinë, si dhe reformën e administratës publike, si më poshtë:

Alokimi financiar indikativ për sektor (€milion)			
2011-2013	<i>Periudha 2007 - 2010¹⁶</i>	<i>Periudha 2011 - 2013</i>	
Spektori 1: Drejtësia dhe Punët e Brendshme	78.50 (18.46%)	61.09	30 %
Spektori 2: Zhvillimi i Sektorit Privat	192.93 (45.38 %)	97.75	48 %
Spektori 3: Reforma e Administratës Publike	106.22 (24.98%)	20.35	10 %
Spektori 4: Tjera	47.55 (11.18%)	24.42	12 %
GJITHSEJ	425.20	203.61	100%

Asistenca financiare do të zbatohet përmes komponentëve relevantë të IPA-së, si më poshtë:

Në milion €

⁽¹⁾ Komponenti i Dytë i IPA-së, Bashkëpunimi Ndër-kufitar, trajtohet në një MIPD të veçantë mbi BNK

Alokimet financiare janë indikative dhe mund të ndryshojnë varësisht prej vetë nevojave financiare të identifikuara në kohën e programimit.

¹⁵ COM (2009) 543 e 14 tetorit 2009.

¹⁶ Dallimi në aspektin e përqindjes në mes të 2007-2010 dhe 2011-2013, është për shkak të dallimeve në kategorizim, të cilat e komplikojë koordinimin e projekteve të financuara nga programe të mëparshme me tre plus një sektorëve strategjike të identifikuara në këtë MIPD.

3.1. Drejtësia dhe Punët e Brendshme (fokusi në liberalizimin e vizave dhe gjyqësorin)

3.1.1. Përshkrimi i sektorit

Sundimi i ligjit është prioritet kyç për Kosovën që duhet adresuar në rrugën e saj drejt BE-së. Sundimi i ligjit është parakusht për qeverisje të mirë, funksionimin e administratës publike dhe zhvillim socio-ekonomik. Përpjekjet e Kosovës për të përmirësuar sundimin e ligjit gjatë periudhës 2011-2013 duhet të merren më tej me perspektivën e liberalizimit të vizave si pikë e tyre e fokusit. Strategjia e Kosovës për liberalizimin e vizave do të vendosë standarde për të matur progresin e saj në fushën e Drejtësisë dhe të Punëve të Brendshme. Progresi i Kosovës edhe më tej do të udhëzohet dhe ndihmohet nga ana e Misionit të BE-së për Sundimin e Ligjit EULEX. Mandati i misionit të EULEX-it është vazhduar deri në qershor 2012. EULEX-i do të vazhdojë të mbikëqyrë, monitorojë dhe këshillojë Kosovën për reformat në fushat e drejtësisë, policisë dhe doganave. EULEX-i gjithashtu do të vazhdojë të ketë disa funksione ekzekutive. Kosova duhet t'i ndjekë zhvillimet në *acquis* dhe standardet evropiane, e cila do të jetë një nga fushat më dinamike të hartimit të politikave në të ardhmen e parashikueshme. Kosova do të duhet t'i parashikojnë dhe t'u përshtatet ndryshimeve të vazhdueshme në legjislacion dhe t'i zbatojë në praktikë ndryshimet e sjella.

Procesi i reformave në gjyqësor ka filluar me miratimin e katër ligjeve të reformës për gjykatat, Këshillin Gjyqësor, Këshillin Prokurorial dhe të ndjekjes penale. Duhet të hartohen planet për t'i zbatuar këto reforma dhe të ndahen mjete. Emërimi dhe rienërimi i gjyqtarëve dhe prokurorëve gjithashtu ka përfunduar. Mbi 340 gjyqtarë dhe prokurorë janë emëruar nga Presidenti në të gjitha nivelet e gjyqësorit, përfshirë emërimin e anëtarëve vendorë të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, të cilët kanë zgjedhur Kryesuesin e Këshillit. Pas dhënies së provimit të jurisprudencës, gjyqtarët dhe prokurorët e parë të ardhshëm kanë diplomuar nga Instituti Gjyqësor i Kosovës në dhjetor të vitit 2009. Megjithatë, ka pasur raste të ndërhyrjes politike në sistemin gjyqësor, sidomos në procesin e riemërimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve. Ende ka në masë të konsiderueshme lëndë të vjetruara, sidomos në çështjet civile, përfshirë të drejtat pronësore. Institucionet e Kosovës duhet t'i japim rëndësi të madhe mbështetjes së hetimeve dhe ndjekjes gjyqësore të krimeve të luftës. Planet e zbatimit të reformave të gjyqësorit duhet të përgatiten dhe të ndahen mjete. Kosova është ende në një fazë të hershme në adresimin e prioritetëve në fushën e drejtësisë.

Për të lëvizur përpara drejt procesit të liberalizimit të vizave, një numër kriteresh do të duhet të plotësohen. Shqetësim përben siguria e dokumenteve dhe funksionimi i duhur i procedurave lidhur me gjendjen civile. Për shkak të çrregullimit të sistemit të gjendjes civile/regjistrimit civil, të shkaktuar nga konflikti i vitit 1999, një numër i regjistrave të lindjeve, vdekjeve dhe martesave janë shkatërruar apo zhvendosur. Regjistri i gjendjes civile siguron bazën për lëshimin e dokumenteve që dëshmojnë identitetin dhe mbetet rreziku që dokumentet zyrtare të tilla si pasaportat e Kosovës të përmbajë të dhëna të gabuara. Bazat komunale të të dhënave të gjendjes civile në të gjithë Kosovën nuk janë të ndërlidhura. Prandaj disa ligje (miratimi i amendamenteve në ligjin për gjendjes civile, të identifikimit si dhe dokumenteve të udhëtimit, përfshirë udhëzimet përkatëse zbatuese), cilësia e të dhënave të gjendjes civile, si dhe funksionimi i zyrave të gjendjes civile duhet të përmirësohen.

Kufijtë e Kosovës janë të brishtë dhe jo plotësisht të sigurt. Veriu paraqet një sfidë të veçantë. Mungesa e funksionimit të plotë të doganave dhe të policisë në këtë zonë pengon luftën efikase kundër krimit të organizuar. Bashkëpunimi ndërmjet organeve të përfshira në menaxhimin e kufirit është i pamjaftueshëm. Kosova duhet të sigurojë që sistemi i TI-së për kontrollin dhe mbikëqyrjen e kufirit të jetë në përputhje me standardet e BE. Kosova vetëm sa ka filluar të adresojë prioritetet e saj si politika e vizave dhe e kufirit dhe menaxhimi i kufirit. Kosova duhet të fillojë zhvillimin e një politike koherente të vizave, në përputhje me standardet evropiane.

Ndonëse nuk ka strategji ose qasje gjithëpërfshirëse të vetme sektoriale në këtë fushë, ekzistojnë një numër strategjish të përziera. Këto prekin menaxhimin e integruar të kufirit, luftën kundër korrupsionit, kundër-terrorizmin, narkotikët, krimin e organizuar, parandalimin e krimit, kontrollin dhe grumbullimin e armëve të vogla dhe të lehta, trafikimin me qenie njerëzore, migrimin, ri-integrimin dhe liberalizimin e vizave. Një numër i reformave kyçe janë ende të nevojshme, të cilat BE-ja duhet ti mbështesë. Kjo mbështetje mund të çojë në zhvillimin e ardhshëm të një qasjeje tërë-sektoriale, mundësisht nën kujdesin e një Bordi të përbashkët për sundimin e ligjit, të bashkë-kryesuar nga Zëvendëskryeministri dhe shefi i Misionit EULEX.

Për sa i përket koordinimit të donatorëve Grupi Punues Sektorial për Sundimin e Ligjit është identifikuar si grup kyç koordinues. Udhëheqjen e sektorit do ta marrë përsipër EULEX-i. Mund të themelohen grupe punuese nën-sektoriale në nivel teknik dhe ka të ngjarë të përqendrohen në gjyqësor, anti-korrupsion dhe krimin e organizuar, vizat, azilin, menaxhimin e kufijve, doganat dhe policinë. Takimi i parë Grupit Punues të Koordinimit të Donatorëve në Sektorin e Sundimit të Ligjit është mbajtur më 9 mars 2011. Të gjithë institucionet e Kosovës dhe përfaqësuesit e komunitetit të donatorëve, përfshirë EULEX-in, u pajtuan zyrtarisht me strukturën e sapo-propozuar për koordinimin e donatorëve të këtij sektori dhe hapat e ardhshëm të përpjekjeve për koordinim në nivel të grupeve punuese nën-sektoriale. Autoritetet e Kosovës përfaqësohen nga këto institucione: Ministria e Integritetit Evropian, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Ekonomisë dhe Financave, Dogana e Kosovës, Këshilli Gjyqësor i Kosovës, Instituti Gjyqësor i Kosovës dhe Këshilli Rregullativ i Prokurimit Publik.

3.1.2. Asistenca në të kaluarën dhe ajo aktuale (BE dhe donatorët tjerë)

Asistenca nga BE-ja tashmë aktivisht mbështet sundimin e ligjit në Kosovë. Në kuadër të kornizës së progresit drejt hapjes së liberalizimit të vizave, përfshirë këtu mbështetjen për progresin në ripranim, migrim dhe azil. Asistenca e BE-së gjithashtu ka ndihmuar përmirësimin e sigurisë së kufijve të Kosovës, përfshirë politikat për menaxhimin e integruar të kufijve (MIK), duke rritur efikasitetin e qarkullimit të personave dhe mallrave nëpërmjet kufijve, avancimin e respektimit të standardeve të BE-së për të drejtat e njeriut, luftën kundër krimit ndërkufitar dhe zbatimin e ligjeve në lidhje me menaxhimin e kufijve të Kosovës. Lufta kundër krimit të organizuar dhe pastrimit të parave është një prej fushave prioritare të BE-së. BE-ja ka mbështetur procesin e verifikimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve të Kosovës, si pjesë e një përpjekjeje për të ndihmuar Kosovën që të përmirësojë integritetin e njerëzve që punojnë në sistemin gjyqësor. BE gjithashtu mbështet reformat në sistemin e arsimit juridik, ka fuqizuar kapacitetet administrative, politikëbërëse dhe të hartimit të ligjeve në

Ministrinë e Drejtësisë. Ajo ndihmon edhe në reduktimin e lëndëve të pazgjidhura nëpër gjykata përmes krijimit të mekanizmave për zgjidhjen alternative të kontesteve, futjes së procedurës së arbitrazhit dhe përmirësimit të performancës së sistemit të lirit me kusht dhe shërbimit korrektues. BE-ja po bashkë-financon zgjerimin dhe përmirësimin e ndërtesave të gjykatave të rëndësishme në Kosovë, dhe më në fund për t'i ofruar gjyqësorit objekte të përshtatshme dhe adekuate. Ministria e Drejtësisë e Kosovës përfiton prej mbështetjes së BE-së për të përmirësuar performancën në funksionimin e drejtësisë për të mitur, dhe ekzekutim më të mirë të vendimeve gjyqësore. Një projekt tjetër mbështet institucionet e Kosovës që luftojnë korrupsionin me qëllim të zhvillimit dhe fuqizimit të politikave dhe kornizës ligjore kundër korrupsionit. Asistenca në te kaluarën dhe ajo aktuale nga BE-ja arrin përafërsisht €90,000,000.

Palët e interesuara kryesore dhe akterët tjerë të rëndësishëm, përveç Komisionit, në sektorin e sundimit të ligjit janë: EULEX-i, Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID), Departamenti Amerikan i Drejtësisë, Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC), Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE), Departamenti i Mbretërisë së Bashkuar për Zhvillim Ndërkombëtar (DfID), Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP), dhe Gesellschaft für Technische Zusammenarbeit Deutsche (GTZ).

3.1.3. Objektivat sektoriale për mbështetje të BE-së gjatë tre viteve të ardhshme

Siç është konfirmuar nga konkluzionet e Këshillit të Çështjeve të Përgjithshme, të dhjetorit 2009, Shtetet Anëtare të BE pajtohen se qytetarët e Kosovës duhet të përfitojnë edhe më tej nga të mirat e përafrimit me BE-në, përfshirë mundësinë për të udhëtuar pa viza në BE. Kjo është e mundur vetëm nëse Kosova mund të sigurojë që të zbatohen reforma të rëndësishme dhe që rregullat e procedurat të respektohen në mënyrë që të minimizohen rreziqet e ndërlidhura me sigurinë e Shteteve Anëtare të BE-së. Pika fillestare për këto reforma është funksionimi i duhur i marrëveshjeve të ripranimit. Kosova duhet të përshtat legjislacionin e saj, të forcojë kapacitetet administrative për procedimin e kërkesave të ripranimit dhe të zbatojë një strategji efektive të ri-integrimit. Ajo gjithashtu duhet të shtojë sigurinë e kufijve të saj dhe të sigurojë menaxhimin e regjistrave civilë dhe lëshimin e dokumenteve.

Kosova do të lëvizë përpara me një qasje të strukturuar për të sjellë qytetarët e Kosovës më afër BE-së përmes dialogut të vizave, me perspektivën e liberalizimit eventual të vizave kur të jenë ndërmarrë reformat e nevojshme. Komisioni do të vazhdojë të vlerësojë rregullisht progresin e Kosovës në zbatimin e masave të nevojshme për të përmbushur kushtet për liberalizimin e vizave, duke u bazuar, në mes të tjerash, në misionet vlerësuese nga ekspertët e Shteteve Anëtare dhe të Komisionit. Komisioni do të mbështesë Kosovën në zbatimin e strategjisë së saj nëpërmjet asistencës teknike dhe financiare. Përveç kësaj, brenda kornizave më të gjera të sundimit të ligjit dhe si një konkluzion për aktivitetet e EULEX-it, Komisioni do të shqyrtojë mundësinë e përfshirjes së Kosovës në nismat e bashkëpunimit gjyqësor, në nivel rajonal, përfshirë asociimin eventual të Kosovës me punën e Europol-it, Eurojust-it dhe Frontex-it, që është në shqyrtim e sipër.¹⁷

¹⁷ Europol: Neni 42 i Konventës së Europol-it dhe Aktit të Këshillit të 3 nëntorit 1998; Eurojust: Neni 26a i Vendimit 2002/187/EC ndryshuar; Frontex: Neni 14 i Rregullores së Këshillit (EC) Nr 2007/2004 e ndryshuar nga Rregullorja (EC) Nr863/2007.

Gjatë periudhës 2011-2013 asistenca e BE në fushën e sundimit të ligjit kryesisht do të përqendrohet në kërkesat strategjike për liberalizimin e vizave. Kjo do të sigurojë nivel të mjaftueshme të pronësisë, duke pasur parasysh dëshirën e Kosovës, që përsëritet shpesh, për t'u bashkuar me pjesën tjetër të rajonit në udhëtimin pa viza për qytetarët e saj. Kërkesat prekin sigurinë e dokumenteve (pasaporta / dokumente udhëtimi, kartat e identitetit dhe dokumentet e seleksionerit), migrimin ilegal, përfshirë ripranimin (menaxhimin e kufijve/kufirit administrativ, politikat e azilit, menaxhimin e migracionit), rendin dhe sigurinë publike (luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit, bashkëpunimin gjyqësor në çështjet penale, bashkëpunimin në zbatimin e ligjit, mbrojtjen e të dhënave), dhe marrëdhëniet e jashtme (lëvizjen e lirë të njerëzve, kushtet dhe procedurat për lëshimin e dokumenteve të identitetit, të drejtat e qytetarëve, përfshirë të drejtat e personave që u përkasin pakicave). Përpyekjet e Kosovës do të synojnë të plotësojnë kërkesat në mënyrë të plotë, duke u fokusuar në kërkesat në kontekst më të gjerë të sundimit të ligjit.

Asistenca e BE-së do të synojë të mbështesë progresin në kontekst më të gjerë të reformës gjyqësore. Kjo do të ndihmojë për të siguruar që miratimin e legjislacionit dhe zbatimin e masave për të arritur progres cilësor dhe të prekshëm, të konfirmuar nga vlerësimet e EULEX-it. Treguesit përfshijnë numrin e hetimeve të suksesshme të filluara dhe të përfunduara, zhvillimin e një sistemi për përcjelljen e dënimeve, rënien e numrit të rasteve në pritje, dhe rritjen në hetimeve të suksesshme disiplinore në kuadër të policisë dhe gjyqësorit, si dhe në administratën publike.

Progresi do të matet kundrejt treguesve të përfshira në strategjitë për sundimin e ligjit. Mbështetja e gjerë dhënë në përmirësimin e menaxhimit të integruar të kufirit të Kosovës duhet të vazhdojë, por përqendrimi duhet të ndryshojë. Fokusi i asistencës së BE duhet të përqendrohet në ndërtimin dhe zgjerimin e aftësive dhe njohurive themelore të policisë kufitare. Kjo do të jetë e rëndësishme për të ndihmuar Kosovën të qëndrojë krah për krah dimensionit rajonal dhe për të parandaluar diskriminimin e qytetarëve nga vendet e treta. Do të jetë i nevojshëm sigurimi i pajisjeve për të ndihmuar sigurimin e kufirit të gjelbër.

Lufta kundër krimit të organizuar do të duhet të përqendrohet, në mes tjerash, në ngritjen e kapaciteteve të saj për të luftuar pastrimin e parave. Iniciativa të reja duhet të synojnë për të ndihmuar në trajnimin dhe furnizimin e institucioneve përkatëse në administratën e Kosovës në kuadër të transferimit të përgjegjësi nga EULEX-it në administratën e Kosovës.

Trafikimi i drogës do të duhet të adresohet me ndihmën e asistencës së BE-së. Ndihma e ardhshme do të duhet të fokusohet në ndërtimin e kapaciteteve për të hetuar dhe për të kryer operacione ndërkufitare. Kapacitetet e Kosovës që të përfshihet në bashkëpunim ligjor ndërkombëtar është thelbësor në luftën kundër krimit të organizuar ndërkufitar. Për këtë do të jetë e nevojshme ndihma e BE-së për të ndihmuar financiarisht në trajnime përkatëse, pajisje, dhe për sigurimin e objekteve.

Suksesi i luftës së Kosovës kundër krimit të organizuar varet nga shkëmbimi me kohë i informatave. Megjithatë, në të njëjtën kohë të dhënat personale duhet të mbrohen, duke respektuar standardet e BE-së. Kosova ka miratuar legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave në prill 2010 dhe do të ketë nevojë për ndihmë në zbatimin e tij. Kjo ka të ngjarë të përfshijë një rregullim të plotë të administratës publike. Do të duhet të vendosen sistemet dhe procedurat për të mbrojtur të dhënat brenda administratës publike, si dhe sektorit privat, që

do të mbikëqyret nga një agjenci, e cila ende nuk është themeluar. Personeli përkatës do të duhet të jetë i trajnuar, në të gjitha nivelet, dhe publiku i gjerë duhet të vetëdijësohet për të drejtat e kësaj agjencie.

Lufta kundër korrupsionit në sektorin publik dhe privat do të mbetet një objektiv i rëndësishëm për Kosovën për të ardhmen e parashikueshme. Për sa i përket ndihmës së BE-së, aktivitetet përcjellëse që burojnë nga projekti i asistencës së vazhdueshme teknike duhet të zhvillohen. Korniza përkatëse legislative duhet të plotësohet dhe të bëhet në përputhje me standardet evropiane. Zbatimi i saj do të duhet të monitorohet. Veprimet përcjellëse do të duhet të përqendrohen në nën-sektorë veç e veç, përfshirë korrupsionin në polici, gjyqësi, shëndetësi, arsim, etj. Progresi në këto fusha do të ketë një ndikim të drejtpërdrejtë në perspektivën për liberalizimin e vizave.

Së fundi, zhvillimi i kornizës më të gjerë duke mbështetur sundimin e ligjit në Kosovë do të varet nga reformat e suksesshme e gjyqësorit në tërësi. Fokusi duhet të jetë në zbatimin e legjislacionit kyç, përfshirë Ligjin për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, atë për Këshillin Prokurorial të Kosovës, si dhe Ligjin për Gjykatat dhe atë për Prokuroritë, përfshirë ndryshimet e thella që do të dalin nga këto ligje sa u përket strukturave dhe proceseve. Asistenca e BE-së në mbështetje të këtij procesi vendimtar do të duhet të jetë gjithëpërfshirëse, përfshirë ngritjen e kapaciteteve, monitorimin, zhvillimin e strukturave administrative dhe përgatitjen e zbatimit të legjislacionit. E njëjta gjë vlen edhe për reformën e Kodit Penal dhe të Kodit të Procedurës Penale.

Si përmbledhje, qëllimi i përgjithshëm i asistencës së IPA-së gjatë tre viteve të ardhshme do të jetë për të mbështetur përpjekjet e autoriteteve të Kosovës në përmbushjen e kushteve për liberalizimin e vizave, të vendosur në kuadër të objektivit të përgjithshëm për të zbatuar sundimin e ligjit përmes forcimit të gjyqësorit, promovimit të integritetit të institucioneve, luftimit të formave të ndryshme të krimit, si dhe përafrimit me dhe zbatimin të *acquis*-së. Fokusi do të jetë në veçanti në forcimin e sistemit gjyqësor për të luftuar krimin e organizuar dhe korrupsionin dhe në mbështetjen e reformimit të policisë. Asistenca e BE-së do të ndërtohet mbi dhe do të koordinohet ngushtë me aktivitetet që kryen EULEX-i, i cili vepron si donator udhëheqës në këtë sektor.

Llojet e indikatorëve për të matur zhvillimet në drejtim të këtyre objektivave janë:

- Kosova përmbush standardet e caktuara për liberalizimin e vizave;
- Reduktimi i kohëzgjatjes së procedurave gjyqësore dhe reduktimi e numrit të rasteve;
- Organizimi efikas dhe efektiv i sistemit gjyqësor, në veçanti përmirësuar i menaxhimit të gjykatave, përfshirë ekspertë gjyqësorë kompetentë dhe efektivë, procedura të brendshme adekuate dhe shfrytëzimi efikas i mekanizmave alternativë të zgjidhjes së konflikteve;
- Numri i ndjekjeve të suksesshme penale për rastet e krimit të organizuar, korrupsionit, pastrimit të parave dhe trafikimit të qenieve njerëzore dhe narkotikëve;
- Numri i trajnimeve (dhe numri i pjesëmarrësve të trajnuar) për zbatimin e ligjit dhe nga gjyqësori;

- Rritja e sasisë së pasurive të konfiskuara të cilat janë kompensuar;
- Kompletimi i kornizës legislative që mbulon, ndër të tjera, anti-diskriminimin ndërmjet grupeve të ndryshme etnike dhe trajtim të barabartë;
- Rregulli kryesor i strategjive ligjore (p.sh. Strategjia kundër krimit të organizuar dhe luftimin e korrupsionit) është që të zbatohen sipas standardeve, dhe që të sigurohet planifikimi me kohë dhe monitorimi adekuat;
- Kushtet e punës dhe infrastruktura e gjyqësorit të Kosovës e modernizuar dhe e përmirësuar;
- Rritja e pajtueshmërisë ligjore me standardet evropiane dhe më *acquis*;
- Rritja e shpejtësisë, shkallës së të qenit proaktiv, efikasitetit dhe efektivitetit në mbledhjen e informatave (përfshirë atyre financiare) dhe të përpunimit nga Policia e Kosovës.

Të gjitha aktivitetet do të marrin parasysh dhe do të programohen në kuadër të projektit të aktiviteteve të EULEX-it.

3.2. Zhvillimi i sektorit privat (fokusi në ambientin e tregtisë dhe biznesit)

3.2.1. Përshkrimi i sektorit

Kosova ka përfituar nga masat autonome tregtare deri më 31 dhjetor 2010, të cilat masa mundësojnë eksport të drejtpërdrejtë dhe pa pagesë në BE të produkteve të prodhuara në Kosovë. Në shkurt 2010, Komisioni propozoi vazhdimin e këtyre masave deri në vitin 2015. Kosova ka ndërmarrë tashmë hapat e parë në integrimin ekonomik dhe ajo është anëtare e Marrëveshjes mbi Hapësirën e Tregtisë së Lirë të Evropës Qendrore (CEFTA) që nga viti 2006. Marrëveshja është nënshkruar nga UNMIK-u, në emër të Kosovës. Kjo marrëveshje ka për qëllim unifikimin, lehtësimin dhe modernizimin e marrëdhënieve tregtare ndërmjet palëve. Qëllimi i marrëveshjes ishte zgjeruar, duke përfshirë produktet bujqësore, edhe pse protokollin përkatës pret nënshkrimin e të gjitha palëve. Ajo gjithashtu parasheh veprimin e një Komiteti të Përbashkët dhe të një Sekretariati, i cili mbështet punën e CEFTA-së.

Përpjekjet e Kosovës që të rrisë kapacitetin e saj për tregti, të përmirësojë mjedisin për biznes dhe të sigurojë zhvillim të pandërprerë socio-ekonomik duhet të udhëhiqen nga përgatitjet e saj për negociatat e ardhshme për marrëveshje të mundshme tregtare me BE-në. Komisioni ka dërguar një mision faktmbledhës në fushën e tregtisë në Kosovë në korrik të vitit 2010. Misioni ka vlerësuar gatishmërinë e Kosovës për të negociuar dhe zbatuar një marrëveshje të tregtisë, dhe për të identifikuar masat që Kosova duhet t'i ndërmarrë për të siguruar progres. Të gjeturat e misionit janë që të udhëzohet Kosova mbi iniciativat që duhet marrë në këtë aspekt. Ato do të përbëjnë një faktor të rëndësishëm në përcaktimin e fushëveprimit dhe kornizës kohore të mbështetjes nga IPA në këtë sektor.

Kosova ka disa strategji që prekin tregtinë, mjedisin e biznesit dhe konkurrencën. Këto mund të jenë të fokusuar më mirë, megjithatë ndonjëherë mund të ketë duplikime. Gjetjet e këtij misioni faktmbledhës do të përfshihen në një plan veprimi, i cili do të përmbajë veprime me

objektiv dhe sekuencë të qartë për të siguruar ndërmarrjen e masave pasuese për adresimin e rekomandimeve specifike. Në vitin 2009, Ministria e Industrisë dhe Tregtisë ka miratuar Strategjinë e Tregtisë për Kosovën. Kjo ministri gjithashtu ka përgatitur një dokument teknik mbi strategjinë e Kosovës për industri. Është duke u punuar në një strategji për Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme. Në vitin 2010, Qeveria e Kosovës ka miratuar Strategjinë e Punësimit të Qëndrueshëm, financuar pjesërisht nga Banka Botërore, përmes fondit të mirëbesimit me shumë donatorë për Strategjinë e Punësimit të Qëndrueshëm dhe Programit të Zhvillimit, në të cilën ka kontribuar Komisioni. Në qershor 2010, Qeveria e Kosovës ka miratuar një strategji për pronësinë intelektuale 2010-14, e cila synon të përforcojë kapacitetin e Zyrës së Pronësisë Intelektuale në Kosovë dhe të përgatisë legjislacionin kyç në fushën e markave tregtare, patentave dhe të dizajnit industrial. Kosova ka për qëllim të formojë një Këshill Kombëtar të Pronësisë Intelektuale. Në fushën e lëvizjes së lirë të mallrave, Kosova synon të miratojë një strategji për zhvillimin e infrastrukturës së metrologjisë.

Kosova është duke bërë progres në disa fusha. Ajo synon të miratojë legjislacionin për mbrojtjen e konkurrencës dhe ndihmë shtetërore, dhe të themelojë zyrat që kanë për detyrë miratimin dhe monitorimin e ndihmës shtetërore. Kosova dëshiron të forcojë kapacitetet e saja administrativ në fushën e mbrojtjes së konsumatorit. Një ligj i ri për prokurimin publik është miratuar në tetor 2010, i cili do të shoqërohet me ngritje të kapaciteteve të institucioneve përkatëse. Kjo duhet të rrisë pavarësinë e tyre. Kosova është në procesin e krijimit të qendrave të integruara (*one-stop shop*) për të lehtësuar ngritjen e bizneseve të reja dhe për të tërhequr investime.

Zhvillimi i një ekonomie funksionale të tregut me një bazë të shëndoshë financiare është një nga fushat prioritare të qeverisë së Kosovës. Për këtë qëllim, Ministria e Integritit Evropian ka krijuar Grupet Punuese Sektoriale (GPS) në Sektorin e Ekonomisë, Tregtisë dhe Industrisë, me këto nën-sektorë: Privatizimi dhe Partneritetet Publiko-Private (PPP), Konkurrenca dhe Tregu i Brendshëm, Zhvillimi i Sektorit Privat dhe Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme (NVM) dhe Zhvillimi Ekonomik Rajonal. Takimi i parë është mbajtur në mars 2010. Institucionet e Kosovës dhe përfaqësuesit e komunitetit të donatorëve kanë rënë dakord zyrtarisht me strukturën e sapo-propozuar për koordinimin e donatorëve në këtë sektor dhe me hapat e ardhshëm të koordinimit dhe përpjekjeve në nivel të GPNS-ve. Institucionet e Kosovës janë të përfaqësuara nga këto institucione: Ministria e Integritit Evropian, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, Ministria e Ekonomisë dhe Financave, Agjencia Kosovare për Privatizim, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, dhe Agjencia për Prokurim Publik dhe Komisioni Kosovar i Konkurrencës. Promovimi i bizneseve private dhe punësimi është komponent kyç për zhvillimin socio-ekonomik të Kosovës, por ky fokusim do të vazhdojë të shkojë paralelisht me mbështetjen për një përfshirje sociale efektive të të gjitha grupeve dhe komuniteteve.

3.2.2. Asistenca në të kaluarën dhe aktuale (BE dhe donatorët e tjerë)

Një masë e konsiderueshme përkrahjeje nga BE-ja është dhënë për zhvillimin ekonomik të Kosovës. Kjo përfshin programin shumëvjeçar për mbështetjen e një qasjeje rajonale të BE-së për Zhvillim Ekonomik në Kosovë, përfshirë ngritjen dhe vënien në funksionim të pesë Agjencive për Zhvillim Rajonal dhe mbështetje financiare për projekte socio-ekonomike nëpërmjet një skeme të granteve lidhur në shkallë të vogël rajonale. BE gjithashtu ka kontribuar në reformimin e shërbimeve të menaxhimit dhe këshillimit të bizneseve. BE-ja ka

financuar zhvillimin e një mjedisi të përshtatshëm ekonomik për të gjitha komunitetet e Kosovës përmes përmirësimit të kapaciteteve menaxhuese dhe operacionale të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, Agjencisë për Promovimin e Investimeve, Zyrës së re të Pronësisë Industriale dhe Zyrës së të Drejtave Autoriale. BE-ja ka përkrahur pasardhësen e Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit për të vazhduar procesin e privatizimit dhe likuidimit. Ajo ka mbështetur rritjen e ndërmarrjeve dhe krijimin e vendeve të punës përmes mbështetjes teknike dhe këshillimore për NVM-të. Asistenca e BE në masë të konsiderueshme ka synuar zhvillimin lokal të ndërmarrjeve dhe krijimin e vendeve të punës në komunat veriore të Kosovës, zbutjen e varfërisë në disa komuna të marginalizuara dhe në zonat e pa-favorizuara të pakicave. Asistenca e BE-së në të kaluarën dhe ajo aktuale arrin përafërsisht shumë prej €30,000,000.

Aktivitetet në këtë sektor janë të lidhura ngushtë me aktivitetet në fushën e drejtësisë, të punëve të brendshme dhe reformën e sektorit publik, pasi që zhvillimi ekonomik preket drejtpërdrejt nga disponueshmëria e një kornize ligjore adekuate dhe funksionale për zhvillimin e biznesit.

Palët e interesuara kryesore dhe akterët e tjerë të rëndësishëm, përveç Komisionit, në sektorin e ekonomisë dhe tregtisë përfshijnë: Bankën Botërore, Kreditanstalt für Wiederaufbau (KfW), USAID, DANIDA, GTZ, DFID, UNDP, EBRD, SIDA, dhe Norwegian Aid.

3.2.3. Objektivat sektoriale për mbështetjen e BE-së gjatë tre viteve të ardhshme

Tregtia dhe aftësia për të tregtuar janë qenësore për Kosovën për të tërhequr investime, stimuluar rritjen ekonomike dhe për të siguruar zhvillimin socio-ekonomik. BE-ja luan një rol të rëndësishëm në këtë, duke qenë partneri kryesor tregtar i Kosovës, në të njëjtin nivel me partnerët e CEFTA-së. Zhvillimi afatgjatë ekonomik i Kosovës kërkon një perspektivë thelbësore, që duhet të jetë e qëndrueshme e që mund të sigurohet vetëm nëpërmjet një marrëveshjeje tregtare. Megjithatë, nevojitet progres substancial para se Kosova të mund të përfitojë nga një marrëveshje tregtare. Një kornizë ligjore e qëndrueshme dhe e parashikueshme për investitorët dhe operatorët e tregut kërkon përparimin e Kosovës në të drejtat e pronësisë intelektuale, konkurrencës, pajtueshmërisë me standardet dhe bashkëpunimit administrativ. Kosova duhet të përparojë me reformat në të gjitha fushat që prekin tregun e brendshëm, përfshirë kapacitetet administrative. Kosova duhet të jetë në gjendje të udhëheqë një politikë tregtare efektive dhe të menaxhojë e kufijtë e saj. Bizneset e Kosovës duhet të jetë në gjendje të përfitojnë nga mundësitë që ofron marrëveshja dhe të jenë në gjendje të përballojnë presionin konkurrues në rritje që do të pasojë.

Komisioni ka vlerësuar përparimin e Kosovës në fushat më të rëndësishme për marrëveshje të tregtisë. Në prill, Kosova ka dorëzuar përgjigjet e saj në pyetësin e Komisionit lidhur me tregtinë, mbledhjet e DPSA-së për sektorin e tregtisë dhe të tregut të brendshëm janë zhvilluar në maj dhe Komisioni ka organizuar një mision faktmbledhës për tregtinë në Kosovë, në korrik të vitit 2010. Rezultatet e këtyre iniciativave do të drejtojnë identifikimin që do të merren parasysh për mbështetje nga IPA-ja. Krahas marrjes së masave të drejtpërdrejta në lidhje me një marrëveshje të mundshme tregtare, Kosova do të ketë nevojë ta zbatojë politika të qëndrueshëm makro-ekonomike. IPA do të vihet në dispozicion për të ndihmuar Kosovën që të adresojë kufizimet e ndërlydhura me ofertën, siç janë dobësitë infrastrukturore, ndërprerjet e energjisë elektrike, qasjen në kapital dhe nivelin e ulët të zotësive.

Në kuadër të strategjisë evropiane për rritje të zgjuar, të qëndrueshme dhe përfshirëse (Evropa 2020), IPA do të mbështesë veprimet që synojnë të përmirësojnë konkurrencën e ekonomisë së Kosovës, rritjen e produktivitetit dhe forcimin e sektorit të saj të eksportit, përmirësimin e niveleve të aftësive dhe mundësive të punësimit të fuqisë së saj punëtore, veçanërisht përmes përmirësimit të performancës së sistemit arsimor dhe lehtësimit të kalimit nga arsimi në punësim, të hyrjes së të rinjve në tregun e punës dhe mbështetjen e aftësive të tyre me anë të mbështetjes për çështje si mësimi jo-formal, pjesëmarrja, vullnetarizmi dhe mobiliteti, duke modernizuar infrastrukturën e saj fizike, për të mbështetur në mënyrë të qëndrueshme dhe për të inkurajuar investimet private.

Mbështetja për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme duhet të përmirësohet për të siguruar stimulimin e sipërmarrjes, nxitjen e inovacionit dhe transformimin e aktiviteteve sipërmarrëse joformale në biznese formale. Kosova do të përfitojë nga programet me qëllim të rritjes së konkurrencës së ekonomisë së saj, me fokus në absorbimin e teknologjisë së re, rritjen e prodhimit dhe prodhimit me vlerë zinxhirore, zvogëlimin e kostos së punës dhe gjenerimin e vendeve të punës. Programet e tilla duhet të ndihmojnë në rritjen e transparencës së rregullimit të bizneseve, përfshirë licencat, lejet dhe certifikimet, si dhe mbikëqyrje efektive dhe të pavarur, dhe të ofrojë mbështetje për iniciativat e rrjeteve. Kosova gjithashtu duhet të shënojë progres të mëtutjeshëm në procesin e privatizimit. Kosova do të përfitojë nga zhvillimi i mëtejshëm i institucioneve mikrofinanciare për mbështetjen e bizneseve të vogla në sektorë me potencial të rritjes, përfshirë bujqësinë dhe zhvillimin rural, përmirësimin e ushqimit bujqësor dhe inkorporimin e kërkesave të BE-së për sigurinë ushqimore dhe sistemet e cilësisë, shërbimet e vogla prodhuese dhe urbane. Përveç ndërtimit të kapaciteteve, Kosova do të përfitojë nga rritja e investimeve në hulumtim dhe inovacion dhe investime kapitale.

BE-ja ka financuar një studim mbi koston e nxjerrjes nga përdorimi të termocentralit (me shkallë të lartë të ndotjes) 'Kosova A', në përputhje me angazhimin e pakushtëzuar të Kryeministrit që ky termocentral të mbyllet deri në vitin 2015. Studimi ka identifikuar një proces të shkallëzuar të veprimeve, dhe Kosova duhet të ndërmarrë masat e nevojshme shoqëruese për të përmbushur afatin e vitit 2015, kurse BE-ja do të financojë disa nga fazat e para në procesin e çmontimit.

Në fushën e bujqësisë dhe sigurisë së ushqimit, BE-ja do të vazhdojë të ndihmojë Kosovën për të përmbushur standardet e BE-së dhe për të zhvilluar kështu potencialin eksportues / të zëvendësimit të importeve, gjithashtu duke ndihmuar ekonominë rurale të Kosovës. Masat që mund të parashikohen janë mbështetja e vazhdueshme për forcimin e kapaciteteve administrative të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, duke mbështetur qendrat bujqësore, planifikimin dhe ndërtimin e plantacionit të parë për përpunimin e materialit shtazor (gjë, që në një masë që do të ndihmojë Kosovën të përmbush standardet e BE-së në sigurinë e ushqimit dhe mjedis), furnizimin e laboratorit të sigurisë ushqimore në Kosovë, duke ndihmuar në zhvillimin e bujqësisë organike, inspektoratin bujqësor dhe certifikimin, regjistrin e ushqimeve bujqësore, sistemin e TI-së për regjistrimin e kafshëve dhe lëvizjes së tyre në Kosovë. BE-ja do të vazhdojë të financojë projekte që ndihmojnë në përmirësimin e mjedisit të Kosovës (në veçanti, ujërat e zeza dhe cilësinë e ajrit) për të kompensuar financimin e tejet të ulët që ky sektor merr nga buxheti i Kosovës.

Si përmbledhje, qëllimi i përgjithshëm i asistencës së IPA-së gjatë tre viteve të ardhshme do të jetë të mbështesë përpjekjet e Kosovës për të përmirësuar mjedisin e saj të biznesit, për të tërhequr investime, stimuluar zhvillimin dhe për të siguruar që zhvillimi socio-ekonomik i Kosovës të mund të vazhdojë. Përpjekjet kryesisht duhet të udhëhiqen nga kërkesat e një marrëveshje të mundshme tregtare me BE-në, dhe do të synojnë ngritjen e kapaciteteve administrative dhe teknike të Kosovës në këtë drejtim. Këto përpjekje do të zhvillohen në kuadër të kornizave më të gjera të aktiviteteve për të mbështetur zhvillimin socio-ekonomik të Kosovës, dhe do të përshtaten me një numër të strategjive sektoriale, sidomos me ato të industrisë së Kosovës, NVM-ve dhe strategjitë e punësimit. Mbështetja do të jetë në linjë me strategjinë evropiane për rritje të zgjuar, të qëndrueshme dhe përfshirëse (Evropa 2020).

Llojet e indikatorëve për të matur zhvillimet në drejtim të këtyre objektivave janë:

- Kosova të përmbush parakushtet për një fillimin e mundshëm të negociatave për marrëveshje të tregtisë, për t'u konfirmuar nga monitorimi nga ana e Komisionit;
- Rritja e normave të investimeve private;
- Përmirësimi i nivelit të aftësive të fuqisë punëtore;
- Përmirësimi i kyçjes së të rinjve në tregun e punës;
- Rritja e qasjes në financa për NVM-të;
- Përmbushja e standardeve të caktuara të BE-së në bujqësi dhe siguri të ushqimit të cilat do të ndihmojnë në zhvillimin e eksportit / zëvendësimin e mundshëm të importit të Kosovës;
- Kompletimi i kornizës ligjore për ndërmarrjet;
- Rritja e investimeve në Hulumtim dhe Zhvillim (R&D) dhe inovacion;
- Hyrja më efikase në treg dhe dalje më efikase nga tregu.

3.3. Reforma e Administratës Publike (fokusi në rishikimin funksional)

3.3.1. Përshkrimi i sektorit

Komunikata për Kosovën nuk e identifikon administratën publike si sektor në vete. Megjithatë, aty konfirmohet rëndësia e saj në mbështetjen e nismave kryesore që identifikon komunikata. Kjo komunikatë qartazi përcakton se prioritet për Kosovën duhet të jetë sigurimi i zbatimit të duhur të legjislacionit të miratuar, përfshirë caktimin e stafit të përshtatshëm, si në nivelin qendror ashtu edhe atë lokal. dhe pajisjet. Administratës publike, pra, i garantohet mbështetje nga IPA si një fushë e tretë prioritare.

Objektivat strategjike të Kosovës në fushën e administratës publike (përfshirë menaxhimin e financave publike) janë gjithëpërfshirëse dhe ambicioze. Kosova duhet të vejë në vend një administratë publike të depolitizuar dhe profesionale, bazuar në politikat evropiane dhe praktikat më të mira për menaxhimin e burimeve njerëzore. Kjo do të kërkojë ngritjen e strukturave efektive horizontale dhe vertikale, të organizuara në atë mënyrë që do të

mundësonte zbatimin efektiv dhe efikas të kompetencave të tyre përkatëse. Duhet të vendoset sistemi i kontroleve dhe balancave, i cili duhet t'i mundësojë çdo subjekti që të luajë rolin e saj/tij. Funksonimi i institucioneve do të duhet të sigurojë një agjent zbatues (Ministria e Administratës Publike), të mbikëqyrjes (Komiteti Ndërmintor i RAP-it) dhe llogaridhënës (Zyra e Auditorit të Përgjithshëm, Avokati i Popullit, auditimi i jashtëm nga Institucioni Suprem i Auditimit [SAI], AKK-ja), në të gjitha nivelet. Kjo, nga ana tjetër, kërkon menaxhim cilësor, transparent dhe të përgjegjshëm të objektivave dhe synimeve; komunikim efektiv me publikun e gjerë dhe ofrimin e shërbimeve publike me cilësi të lartë. Kjo gjithashtu kërkon menaxhimin dhe mbikëqyrjen efektive të sistemeve të shpenzimeve publike dhe sisteme të besueshme për të parandaluar dhe luftuar korrupsionin.

Në vijim të rishikimit funksional të vitit 2009 të detyrave dhe përgjegjësi brenda administratës publike (financuar nga DfID), Kosova ka miratuar Strategjinë e rishikuar për Reformën e Administratës Publike dhe tani duhet të përgatisë dhe miratojë planin e veprimit të nevojshëm për zbatimin e saj. Është planifikuar mbështetje nga SIGMA dhe TAIEK për të mbështetur finalizimin e këtyre dokumenteve dhe për të siguruar identifikimin dhe artikullimin e prioriteteve të Kosovës për periudhën afatshkurtër dhe afatmesme. Këto prioritete do të duhet të pasqyrojnë Partneritetin Evropian në lidhje me reformën e administratës publike në Kosovë. Ministrisë së Administratës Publike duhet t'i ofrohet përkrahje politike për t'i mundësuar që të shtyjë përpara reformën e administratës publike nëpërmjet zhvillimit të një strategjie gjithëpërfshirëse sektoriale dhe një udhëzuesi përkatës. Bashkëpunimi i ngushtë ndërmjet Ministrisë së Administratës Publike dhe Ministrisë së Integritimit Evropian do të jetë vendimtar në vitet e ardhshme, sepse agenda e reformës së administratës publike është e lidhur ngushtë me procesin e integritimit në BE. Bashkëpunimi i ngushtë ndërmjet Ministrisë së Administratës Publike dhe Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave është i nevojshëm për të siguruar që reformat në administratën publike të kenë qëndrueshmëri fiskale. Këto reforma duhet të jenë të lidhura me përmirësimet e vazhdueshme në menaxhimin e shpenzimeve publike të Kosovës, të udhëhequra nga Plani i Veprimit për Reformimin e Menaxhimit të Financave.

Kosova duhet të miratojë legjislacionin përkatës për zbatimin e Ligjit për Shërbimin Civil dhe atij për Pagat. Zbatimi i Ligjit për Pagat do të duhet të pasqyrojë marrëveshjen e kohëve të fundit të Kosovës me FMN-në. Këto dy ligje kanë hyrë në fuqi në janar 2011. Komisioni Parlamentar për Integritim Evropian do të jetë përgjegjës për të verifikuar që legjislacioni të jetë në përputhje me praktikën ekzistuese të BE-së. Kapaciteti i Ministrisë së Integritimit Evropian dhe Parlamentit duhet të fuqizohet dhe baza e njohurive të tyre për BE-në duhet përmirësuar dukshëm. Objektivi strategjik është përmirësimi i gjendjes së tyre në raport me akterët vendorë dhe ndërkombëtarë, dhe zhvillimi i besueshmërisë në to si udhëheqës dhe kujdestarë të një procesi të reformës së administratës publike të orientuar drejt BE-së.

Në vitin 2010 Kuvendi ka miratuar për të dytin vit radhazi Planin e Veprimit për Integritim Evropian, i cili reflekton sfidat në procesin e integritimit evropian të Kosovës dhe në këtë mënyrë jep udhëzime për Komisionet Parlamentare. Ka pasur progres në reformën e pushtetit lokal dhe decentralizim me formimin e katër komunave të reja dhe përpjekjet për të formuar një tjetër. Ministria e Pushtetit Lokal duhet të fokusohet në decentralizimin e kompetencave në komuna, duke siguruar një lidhje në mes të buxhetit dhe ofrimit të shërbimeve në nivelin lokal.

Qeveria ka rritur përpjekjet e saj në drejtim të koordinimit të donatorëve dhe integritimit

evropian në përgjithësi. Në prill 2010, është themeluar Ministria e Integritit Evropian (MIE), si organ kryesor koordinues. Mision i Ministrisë është të sigurojë menaxhimin teknik, bashkërendimin dhe monitorimin e procesit të integritit në BE, nëpërmjet përafrimit të legjislacionit të Kosovës me *acquis*, përgatitja e politikave të integritit evropian, koordinimi i asistencës financiare dhe informimi i publikut mbi procesin e integritit në BE.

Kosova ka themeluar një strukturë të organeve për të koordinuar, shqyrtuar dhe mbikëqyrur ndihmën e vazhdueshme të donatorëve, ecurinë e strategjive të lidhura me këtë sektor, programet e donatorëve dhe projektet individuale: Forum i Nivelit të Lartë (FNL), Grupet Punuese Sektoriale (GSP) dhe Grupet Punuese Nën-sektoriale (GPNS). Grupi Punues Sektorial për Qeverisje përfshin këto nën-sektorë: Reformën e Administratës Publike, Pushtetin Lokal dhe Decentralizimin, si dhe Kulturën dhe Trashëgiminë Kulturore. Takimi i parë është mbajtur në mars 2010, dhe institucionet e Kosovës dhe përfaqësuesit e komunitetit të donatorëve kanë rënë dakord zyrtarisht me strukturën e sapo-propozuar për koordinimin e donatorëve në këtë sektor dhe hapat e ardhshëm të koordinimit të përpjekjeve në nivel të GPNS-ve. Autoritetet e Kosovës përfaqësohen nga këto institucione: Ministria e Integritit Evropian, Ministria e Administratës Publike, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve.

3.3.2. Asistenca në të kaluarën dhe aktuale (BE dhe donatorët e tjerë)

Kjo fushë prioritare ka përfituar nga asistenca e BE-së në mënyrë të konsiderueshme deri më tani. Kjo përfshin programin shumëvjeçar të bursave për shërbimin civil nga BE-ja (Skema e Celulave të Reja), i cili mbështet zhvillimin e një kapaciteti më efikas dhe efektiv të administratës së shërbimit civil të Kosovës. Qeverisja lokale dhe procesi më i gjerë i decentralizimit janë mbështetur si nëpërmjet asistencës për Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal ashtu dhe përmes programeve shumëvjeçare në nivel komunal, përfshirë investime të konsiderueshme në zhvillimin e infrastrukturës komunale. Për më tepër, Ministria e Integritit Evropian ka marrë asistencë teknike dhe aktualisht përfiton nga një projekt i Binjakëzimit.

Mbështetje e konsiderueshme është dhënë edhe në përmirësimin e menaxhimit të financave publike për të siguruar administrimin e duhur të fondeve publike, transparencë dhe efikasitet në shpenzimet publike. Kjo përfshin ndihmë të vazhdueshme për Zyrën e Auditorit të Përgjithshëm, duke mbështetur funksionimin e kornizave të kontrollit financiar dhe sistemeve të auditimit të brendshëm dhe mbështetje në përmirësimin e cilësisë së vendimeve për alokimin e investimeve, nëpërmjet zhvillimit të mëtejshëm të Programit të Investimeve Publike. Përveç kësaj, ndihmë u është dhënë edhe organeve të prokurimit publik.

Palët e interesuara kryesore dhe akterët e tjerë të rëndësishëm, përveç Komisionit, në këtë sektor përfshijnë: USAID, DfID, OSBE, SIDA, Bankën Botërore, GTZ dhe Zyrën Zvicerane.

3.3.3. Objektivat sektoriale për mbështetjen e BE-së gjatë tre viteve të ardhshme

Raporti i Progresit për Kosovën konfirmon se Kosova ka përfunduar rishikimin e detyrave dhe përgjegjësisive brenda administratës publike (rishikimin funksional). Disa nga rekomandimet e rishikimit janë zbatuar. Rishikime të veçanta janë zhvilluar për disa ministri. Janë formuar grupet punuese për mbikëqyrjen e procesit të reformës së administratës publike.

Ligji mbi shërbimin civil dhe ai mbi pagat e shërbyesve civilë janë miratuar nga Parlamenti në maj dhe janë dekretuar në qershor 2010. Ligji për administratën shtetërore është miratuar në shtator 2010 dhe ligji mbi qeverinë duhet të miratohet gjatë vitit 2011. Legjislacioni zbatues duhet të hartohet kah fundi i vitit 2011. Ligji i punës është dërguar në Parlament në qershor 2010 dhe është miratuar në nëntor 2010. Këto ligje janë të rëndësishme pasi që do të sigurojnë pavarësinë e shërbimit civil. Tani Kosova duhet të përqendrohet në zbatimin e tyre. Raporti i Progresit më tej konfirmon se Instituti Kosovar i Administratës Publike, i cili ofron trajnime dhe certifikimin e nëpunësve civilë, ka kapacitete dhe burime të kufizuara, gjë që ndikon në cilësinë dhe sasinë e trajnimeve të ofruara. Instituti duhet të integrohet më mirë në aktivitetet e Shkollës Rajonale për Administratë Publike. Nevojiten përpjekje të mëtejshme për të ngritur kapacitetet e institucioneve përgjegjëse për reformën e administratës publike dhe për të mundësuar transferimin e njohurive dhe praktikave më të mira në të gjithë rajonin.

Sigurimi i ofrimit të shërbimeve publike për të gjithë qytetarët në Kosovë dhe krijimi i një administrate publike profesionale, të përgjegjshme, të qasshme, përfaqësuese e pa ndikime politike vazhdon të jetë prioritet kyç i Partneritetit Evropian. Është gjithashtu thelbësore që të sigurohet qëndrueshmëria e përparimit të Kosovës në fushat strategjike të sundimit të ligjit dhe mjedisit tregtar/biznesor. Komisioni propozon fokusimin e asistencës së IPA-së për të ndihmuar progresin e Kosovës në reformën e administratës publike, në kuadër të kornizave strategjike të zbatimit të rishikimit funksional.

Reforma e administratës publike është një sektor pikë-takues me rëndësi për të gjitha fushat e agjendës evropiane të Kosovës për reforma. Prandaj asistenca e IPA-së duhet të mobilizohet në mënyrë gjithëpërfshirëse. Ndihma në reformën e administratës publike duhet të udhëhiqet nga Strategjia e përditësuar e Kosovës për Reformën e Administratës Publike. Strategjia fillestare e vitit 2007 identifikonte tetë fusha strategjike ku përmirësimet do të sillnin ndikim pozitiv në ofrimin e shërbimeve publike në Kosovë. Këto fusha janë: menaxhimi i burimeve njerëzore, struktura institucionale, komunikimi me qytetarët, menaxhimi në administratën publike, e-Qeverisja, financimi i administratës publike, anti-korrupsioni, dhe përmirësimi i politikave e legjislacionit. Mbështetja e IPA-së mund të parashikohet në secilën prej këtyre fushave. Megjithatë, në planin afatshkurtër, ndihma duhet të përqendrohet në veçanti në forcimin e katër institucioneve qendrore: Parlamentit, Ministrisë së Integritetit Evropian, Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave, dhe Ministrisë së Administratës Publike, si në vijim:

- Përmirësimin e performancës së administratës publike në Kosovë, me fokus të veçantë në krijimin e një administrate publike të përgjegjshme dhe efikase, në nivelin qendror dhe atë lokal, të aftë për t'u përballur me sfidat e integritetit në BE.
- Përmirësimi i kapaciteteve horizontale institucionale të nevojshëm për implementimin dhe zbatimin e strategjive sektoriale dhe politikave evropiane (bujqësinë dhe zhvillimin rural, sigurinë e ushqimit, shëndetin publik, mjedisin, ndryshimet klimatike, energjinë, transportin, punësimin dhe zhvillimin social, mediat, komunikimet elektronike, shoqërinë informative, etj), përfshirë mekanizmat për verifikimin e përputhshmërisë së politikave dhe legjislacionit me ato të BE-së;
- Përmirësimi i sistemeve financiare të administrimit për kontroll më të mirë të financave

publike, përfshirë performancën e mekanizmave të kontrollit dhe auditimit për prokurimin publik dhe mbledhjen e tatimeve, në të gjitha nivelet.

- Përmirësimi i prodhimit të statistikave në përputhje me kërkesat e BE.
- Përmirësimi i kapaciteteve zbatuese për shërbimet e ofruara.

Si përmbledhje, qëllimi i përgjithshëm i asistencës IPA gjatë tre viteve të ardhshme do të jetë mbështetja e Kosovës në sigurimin e ofrit të shërbimeve publike për të gjithë qytetarët dhe krijimin e një administrate publike profesionale, të përgjegjshme, të qasshme e përfaqësuese, në nivelin qendror dhe atë lokal, si dhe të lirë nga ndërhyrje politike, në veçanti bazuar në Strategjinë e rishikuar të Kosovës për Reformën e Administratës Publike dhe Planin përkatës të Veprimit, të cilat janë zhvilluar me ndihmë nga BE-ja.

Gjithashtu duhet të kryhet një vlerësim mbi Shpenzimet Publike dhe Llogaridhënien Financiare (PEFA) në fushën e Reformës së Administratës Publike.

Llojet e indikatorëve për të matur zhvillimet në drejtim të këtyre objektivave janë:

- Sistemi i shërbimit civil në përputhje me standardet evropiane;
- Zbatimi i rekomandimeve të rishikimit funksional;
- Reduktimi i humbjes së personelit nga sektori publik pas zgjedhjeve;
- Ngritja e kapacitetit të ministrive për të zhvilluar, vlerësuar dhe buxhetuar propozimet;
- Krijimi dhe zhvillimi i mekanizmave të shëndoshë të administratës publike, në përputhje me standardet evropiane dhe praktikën më të mira, të konfirmuar nga një sistem gjithëpërfshirës i monitorimit të performancës në shërbimin civil;
- Plani gjithëpërfshirës i veprimit për reformën e administratës publike, në nivel kombëtar dhe lokal, i përgatitur, miratuar dhe zbatuar në të gjitha nivelet, me koherencë midis objektivave, detyrave dhe alokimeve buxhetore, afate kohore dhe tregues, dhe ndarje të qartë të përgjegjësi midis niveleve;
- Krijimi dhe zbatimi i mekanizmave që mundësojnë monitorim efikas dhe efektiv të mbikëqyrjes parlamentare dhe të procesit legjislativ e ekzekutiv;
- Rritja e efikasitetit dhe efektivitetit në programimin dhe implementimin e asistencës së donatorëve, të konfirmuar nga Platforma për Menaxhimin e Ndihmës dhe të matur nga treguesit e monitorimit të Deklaratës së Parisit mbi Efektivitetin e Ndihmës së Jashtme;
- Krijimi dhe zbatimi e kontrollit të brendshëm, funksionimi i auditimit dhe mekanizmave, në përputhje me kërkesat e *acquis-së* së BE-së, standardet përkatëse dhe praktikën më të mira;
- Krijimi dhe zbatimi i procedurave të prokurimit publik në përputhje me kërkesat e standardeve përkatëse, *acquis*, dhe praktikën më të mira.

- Përmirësimi i efikasitetit dhe efektivitetit në ofrimin e shërbimeve, përfshirë në nivelin lokal.

4. LISTA E SHKURTESAVE

CARDS	Community Assistance for Reconstruction, Development and Stabilisation / Asistenca e Komunitetit për Rindërtim, Zhvillim dhe Stabilizim
BNK	Bashkëpunimi Ndër-Kufitar
BQK	Banka Qendrore e Kosovës
CEFTA	Central European Free Trade Agreement / Marrëveshja për Tregti të Lire për vendet e Evropës Qendrore
DANIDA	Danish International Development Agency / Agjencia Daneze për Zhvillim Ndërkombëtar
DfID	UK Department of International Development / Departamenti i MB për Zhvillim Ndërkombëtar
BERZh	Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim
PE	Partneriteti Evropian
PVPE	Plani i Veprimit për implementimin e Partneritetit Evropian
BE	Bashkimi Evropian
EULEX	European Union Rule of Law Mission in Kosovo / Misioni i Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë
FDI	Foreign Direct Investment/ Investime të Jashtme të Drejtpërdrejta
BPV	Bruto Prodhimi Vendor
GTZ	Deutsche Gesellschaft für Technische Zusammenarbeit
FNL	Forumi i Nivelit të Lartë
MIK	Menaxhimi i Integruar i Kufijve
GJND	Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë
ICR/PCN	International Civilian Representative/Përfaqësuesi Civil Ndërkombëtar
FMN	Fondi Monetar Ndërkombëtar
IPA	Instrument for Pre-accession Assistance / Instrumenti i Asistencës së Para-anëtarësimit
TI	Teknologji Informativ
KFOR	Kosovo Force / Forca e Kosovës
KfW	Kreditanstalt für Wiederaufbau
KPK-KGjK	Këshilli Prokurorial i Kosovës – Këshilli Gjyqësor i Kosovës
MIE	Ministria e Integritit Evropian
MIPD	Multi-annual Indicative Planning Document / Dokumenti Planifikues Indikativ Shumëvjeçar
KASH	Korniza Afatmesme e Shpenzimeve
NATO	Organizata e Traktatit Veri-Atlantik
OSBE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
RAP	Reforma e Administratës Publike
PPP	Partneritet Publiko-Privat
PSA	Procesi i Stabilizim-Asociimit
DPSA	Dialogu i Procesi të Stabilizim-Asociimit
QBS	Qasja e Bazuar në Sektorë
SDC	Swiss Agency for Development and Cooperation / Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim
SIDA	Swedish International Development Cooperation Agency / Agjencia Suedeze për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar
SIGMA	Support for Improvement in Governance and Management / Mbështetje për Përmirësimin e Qeverisjes dhe Menaxhimit

NMV	Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme
ESK	Enti Statistikor i Kosovës
GPNS	Grupet Punuese Nën-sektoriale
GPS	Grupet Punuese Sektoriale
TAIEX	Technical Assistance and Information Exchange Instrument /Instrumenti i Asistencës Teknike dhe Shkëmbimit të Informacionit
TAM/BAS	Turn-Around Management and Business Advisory Services /Menaxhimi Ciklik dhe Shërbimet e Këshillimit për Biznese
OKB	Organizata e Kombeve të Bashkuara
UNDP	United Nations Development Programme /Programi i OKB-së për Zhvillim
UNGA	United Nations General Assembly /Asambleja e Përgjithshme e OKB-së
UNMIK	United Nations Mission in Kosovo /Misioni i OKB-së në Kosovë
USAID	United States Agency for International Development /Agjencia e SHBA-së për Zhvillim Ndërkombëtar